

# PRONAT, SHTYHET ME 6 MUAJ LIGJI PER KOMPESIMIN

Edi Rama e Sali Berisha debat për përgjimin



# [SHQIPTARJA.com]

LEKË 30

VITI V - NR. 106 - E PREMTE - 08-05-2015



# LEGALIZIMET

## FUTEN NE PROCES EDHE NDERTIMET PA LEJE PAS 2009

Kryeministri ka deklaruar dje se do të hiqet neni që përjashton nga procesi i legalizimit ndërtimet e reja. Kush do përfitojë

► FAQE 2-3

INTERVISTA

► FAQE 11

**NORA MALAJ: MËSUESIT DO TESTOHEN JO PËR DIJET, POR PËR AFTËSITË**



Blue Medical Center  
Vizita, Analiza & Diagnostikim  
Të garantuara sipas protokolleve të mjekësisë bashkëkohore nga Blue Medical Center

**Të parandalosh, më mirë se të kurosh!**


Adresa: Rruga "Bardhyl" Nr.101, Tiranë Cel: +355 66 20 90 008  
Tel: + 355 4 2370 668 Email: info@bmc.al, www.bmc.al

**LISTA**

Ja barnat që nuk rimbursohen më në 2015

10


**ZGJEDHJET**



Duma s' regjistrohesh nga KQZ, probleme me mbiemrin

6

**DOKUMENTI '90**



Vrasja në Kavajë, si u hodh fajti nga sambistët tek polici

18

**OPINION**  
NGA GENC KONDI



Shqipëria në gjurmën e një "TAP"-i të dytë

Pas afirmimit të përfshirjes së vendit tonë në gazsjellësin TransAlbanian Pipeline (TAP), që së shpejti fillon punën për ndërtimin,...

► vijon në faqen 17

**PERIFERI**  
NGA ALBA MALLTEZI



Pa dashuri...

Po bëhen shumë aktivitete për artin në Tiranë, por të ftohta, pa shpirt. Vijnë komunikata në redaksi dhe duket sikur edhe ata që i bëjnë këto aktivitete nuk i besojnë.

► vijon në faqen 17

# » KUVENDI

JUXHIN MUSTAFARAJ  
TIRANE

Kryeministri Edi Rama ka folur dje për herë të parë për dy audio-përgjime të publikuara në media dy ditët e fundit nga ish-kryeministri Sali Berisha. Duke cituar urdhrin e firmosur prej tij pak ditë më parë nga i cili kërkonte distancimin e të gjithë institucioneve shtetërore nga fushata elektorale, kryeministri u shpreh se shteti nuk është përdorur për fushatë elektorale. Sipas Ramës, drejtorët të cilët përmenden në përgjimin e Berishës nuk janë drejtorë të administratës. "Meqë u hap tema e të shkuarit mbrapa ferrave dhe e përpjekjes për të kthyer përmbys një fakt që po e them si ka ndodhur, si ndodh dhe si do ndodhë. Ne nuk i mbledhim drejtorët e administratës tu themi tani ju shteti, jeni partia, ne partia jemi shteti dhe ju duhet të mbushni mitingjet tona dhe partitë tona. Në mbledhjet tona janë të pranishëm dhe drejtorë që janë në administratë që janë pjesë e strukturave të PS-së dhe nuk vijen aty se janë drejtorë por se janë pjesë e strukturave të PS-së. Nëse ju do të gjeni çfarëdo rasti të çfarëdo natyre tjetër që lidh administratën me interesat e fushatës së PS, LSI apo të gjithë partive të koalicionit tonë që kanë lidhje me qeverisjen të jeni të sigurtë që përgjigja do të jetë e menjëhershme dhe krejt e kundërt nga përgjigjet që merrni", u shpreh Rama. Kryeministri qartësoi edhe detaje të tjera nga takimi duke i kujtuar Berishës se në takim ka qenë edhe një drejtor i emëruar prej tij por që askush nuk e ka lëvizur për ta nxjerrë jashtë. "Në Shkodër meqë i referoheni një materiali të nxjerrë por të nxjerrë nga konteksti, përpara se të shkonim për prezantimin e kandidatëve ne kemi pasur një vizitë në një nga strukturat e sektorëve të sukseshëm të administrimit. Nuk më kujtohet koha, por aty drejton një djalë që e keni vndosur ju dhe që ne jo vetëm nuk e kemi lëvizur por mbështetur sepse është menaxher i shkëlqyer, dhe pyeteni nëse ishte në mbledhje me strukturat apo jo? Sigurisht që në takimet tona strukturat nuk i ndajmë kush është drejtor apo jo. Bëhet fjalë për takimet me strukturat për organizimin. Se nga ai organizim keni parë mirë si dilni me ne dhe do e shikoni prapë si do dilni më 21 qershor", theksoi kreu i qeverisë.

ato. Për hir të privatisësë i hoqa figurën por kemi të bëjmë me një proces themelor që janë zgjedhjet", tha Berisha. Ish-kryeministri kur foli për takimin e Shkodrës nuk la pa akuzuar edhe kandidaten e mazhorancës Keti Bazhdarin. "Unë nuk dua të merrem me kandidaten por meqë po sheh Bazhdarin po e them këtu, ia kam thënë dhe më përpara. Pasuria e saj është me tytë revolesh. Kujt ia mori Keti pasurinë? Si na lindi Keti pasunare e madhe? Si na u bë?! E bija e një ish të përndjekuri? Me revolen ndaj kujt? Jua them unë: Me revole ndaj të dashurit të vet që e kishte me depression", përfundoi Berisha.

# Rama: Video e Berishës, përgjim pas ferre, drejtorët janë në PS-së

## Berisha: Materialin do ja çoj ndërkombëtarëve, akuza të forta për pasurinë e Bazhdarit

në çdo zyrë të Europës e Botës që nesër. S'kam përdorur asgjë private të asnjëri. E di mirë se

cilat kanë qenë përgjigjet që mund të përdoren ndaj tij por unë nuk kam për ti përdorur

ato. Për hir të privatisësë i hoqa figurën por kemi të bëjmë me një proces themelor që

janë zgjedhjet", tha Berisha. Ish-kryeministri kur foli për takimin e Shkodrës nuk la pa akuzuar edhe kandidaten e mazhorancës Keti Bazhdarin. "Unë nuk dua të merrem me kandidaten por meqë po sheh Bazhdarin po e them këtu, ia kam thënë dhe më përpara. Pasuria e saj është me tytë revolesh. Kujt ia mori Keti pasurinë? Si na lindi Keti pasunare e madhe? Si na u bë?! E bija e një ish të përndjekuri? Me revolen ndaj kujt? Jua them unë: Me revole ndaj të dashurit të vet që e kishte me depression", përfundoi Berisha.

### Fëmijët

Siguroj se koha kur nxënësit përdoren për të mbushur sheshet, mbylleshin shkollat ka vdekur. Në rast se ju apo qytetarët do të denoncojnë dhe një shkollë të vetme që mbyllet për të nxjerrë nxënësit në takime elektorale të jeni të sigurtë që do të merren masa që nga drejtori i shkollës deri tek drejtorja e arsimit.



### Akuzat



### Balla

"Shikojeni, është më e madhe se Shtëpia e Bardhë, është vila e Saliut në bregdet. Të shtunë e të diel mund ta shikoni Saliun duke bërë plazh aty. Dramën familjare të vetën Saliu bën gabim që e fut në parlament".



### Ndreu

"Ja ku i keni votat që merrte me listë Xhelal Mziu. Ja votat e idhullit tuaj të famshëm Xhelal. Një njeri që e keni simbol të shëmtisë e promovoni, ju s'keni moral të akuzoni askënd për presione politike"

### Përzgjedhja

## Votohet me 74 vota si kryetar të KKRTSH, Kristaq Traja

— Kuvendi ka votuar me 74 vota kandidaturën e Kristaq Trajës në kryet të Këshillit Drejtues të Radio Televizionit Publik Shqiptar. Pavarësisht kundërshtimeve të kryetarit të Komisionit të Medias, Genç Pollo lidhur me formulën që duhet të ndiqej për votimin e kandidatëve, Traja mori mbështetje më të madhe nga parlamenti përball kandidatëve të Artan Mullajt, Andi Kananajt dhe Blerim Kolës. Tashmë këshilli drejtues i RTSH është i plotë dhe mund të nis nga puna pas shumë kohësh në të cilat ka qenë i bllokuar. Seancën e djeshme u votua gjithashtu shtyrja e ligjit për kthimin e kompesimin e pronave, "Për shërbimin postar", projektrezolutën "për



mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT", "Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive". Gjithashtu dje në seancë u miratua projektligji për ratifikimin e marrëveshjes Shqipëri-SHBA për forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjen e mirë.

### Raporti

## Ruçi: Opozita vetëm përbalt asnjë alternative konkrete

— Kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Gramoz Ruçi ka akuzuar dje deputetët e opozitës se nëpërmjet baltjes dhe sherrit në parlament nuk po ofrojnë asnjë alternativë. Duke ju refuzuar një raport që kishte të bënte me mënyrën se si qytetarët perceptojnë politikën, Ruçi u shpreh se qeveria nuk po bën detyrë sa. "Opozita nuk ka pasur asnjë alternativë në këto 18 muaj. Opozita nuk tha asnjë fjalë për reformën territoriale, asnjë fjalë për reformën e pensioneve dhe reformat e tjera. Të njëjtën gjë mund të them për reformën në arsim, reformën në shëndetësi dhe atë në drejtësi. Kujeni? Qytetarët ju kanë votuar që të jeni sa më të përfshirë dhe më luajalë, në mënyrë që të vijni për t'u votuar", tha Ruçi. Ndërkohë



që deputetja e PD, Jozefina Topalli theksoi se raporti flet për mazhorancën. "Ajo që lexon Ruçi për deputetët që kërkohen në rrethe dhe i mungon kontakti, nuk është për të opozitës se po i takoi do të kafshojnë pak nga qeverisja lokale, por është problem për rilindjen", tha ajo.

### REAGIMI

Ish-kryeministri Berisha i ka qëndruar akuzave të bëra për vjedhje votash nga mazhoranca, ndërkohë që siguroi që materiali do t'i kaloi ndërkombëtarëve. "Mos kini merak. Ky regjistrim do shkojë



**Fino**  
Qeveria aktuale në vitin 2013 ka trashëguar dosje të panumërta, rreth 9300 dosje të hapura pa një zgjidhje, ndërkohë që të gjitha me ligjin e ri do të marrin drejtim



**Bylykbashi**  
Këtë 2-vjeçar ka ndaluar plotësisht procesi i kompensimit të pronave dhe fatura financiare që do t'i vijë Shqipërisë është duke u rritur dhe këtë e paguajnë shqiptarët




**Berisha**  
Të ndryshosh pas 2 vjetësh nenin për të zgatur afatin, ndërkohë që nuk u ke dhënë asnjë kacidhe ish-pronarëve ky është dështim. Shpërbleni njëri-tjetrin tani.


## Precedentët

# Qeveria shtyn me gjashtë muaj ligjin për kompesimin e pronave

Rama: Çështja e pronave është kthyer në gangrenë me ligjin e ri zgjidhje përfundimtarëve pronarëve



### Votimi



## Qeveria miraton rezolutën për LGBT

Parlamenti miratoi dje me 74 vota pro 2 kundër dhe një abstenim projektrezolutën për komunitetin LGBT. Rezoluta e cila është diskutuar që në muajin dhjetor të vitit 2014, ngjalli shumë debate për shkak të ndryshimeve që përfaqësuesja e ministrisë së drejtësisë paralajmëroi se do të vijnë në Kuvend. Përfaqësuesja e ministrisë së drejtësisë, paralajmëroi se falë dakordësisë së arritur pritet që në draftin që do të dorëzohet së shpejti në Kuvend të pranohet ligjërisht edhe bashkëjetesa e partnerëve të të njëjtit seks. Ndërkohë në rezolutën e miratur parashikohet, mbrojtja e anëtarëve të komunitetit LGBT nga fyerjet, dhuna dhe çdo lloj diskriminimi. Ky votim është shoqëruar edhe me batuta dhe ilaritet në sallën e parlamentit.

### JUXHIN MUSTAFARAJ TIRANE

Kuvendi miratoi dje me 91 vota pro ligjin për kthimin dhe kompesimin e pronave. Ligji që ngjalli debate të forta në seancë plenare do t'i krijojë mundësinë ish-pronarëve të pasurive të paluajshmë zgotatjen e afateve me 6 muaj për trajtimin e kërkesave të tyre për njohje, kthim dhe kompesim pasurie nga data 30 prill 2015 më 30 tetor 2015. Në seancën e djeshme, kryeministri Rama premtoi se brenda 6 muajve qeveria do të sjellë një ligj të ri kompesimin e pronave. "Nder vite ligji ka qenë objekt i 14 ndërhyrjeve e ndryshimeve ligjore. Ligjit të vitit 2004 nuk i ka mbetur as nam e as nishan dhe ndryshimet e bëra kanë sjellë më shumë ilegalitet. Nuk ka më arsye që ky ligj të ekzistojë, ndaj brenda 6 muajve ne do sjellim ligjin e ri që zgjidh këtë problematikë, që na i lanë peshqesh këta që ikën me turp më 23 qershor", u shpreh Rama. Sipas kryeministrit administrate e re ka bërë një sistem të ri nëpërmjet të cilit mund të identifikohen më lehtë dosjt ndryshe nga e shkuara në të cilën kanë vepruar interesat e ngushta të individëve të caktuar. "Dosjet janë sistemuar dhe presin vendim-marrjen administrative pas një inventarizimi të kryer në atë magazinë, që ishte ndër shëmbëllytrat e turpshme të shtetit shqiptar, shtet i bërë copë-copë. Sot nuk ka më dosje të zgjedhura për t'u shqyrtuar sipas kërkesës së klientit të radhës. Të gjitha

dosjet kanë dalë për shqyrtim dhe vijon puna administrative", deklaroi kryeministri.

### REAGIMI

Ndërkohë deputeti demokrat Oerd Bylykbashi u shpreh se qeveria ka bllokuar kompesimin e pronave tek ish-pronarët dhe ndërhyrja në këtë ligj si dhe rishikimi i tij kaq i shpeshtë është i pal-

igjshëm. "Gjatë këtij 2-vjeçari të qeverisjes tuaj ka ndaluar plotësisht procesi i kompensimit të pronave dhe fatura financiare që do t'i vijë Shqipërisë është duke u rritur dhe këtë do ta paguajnë shqiptarët me taksat e tyre", tha Bylykbashi. Lidhur me këtë ligj kanë debatuar mes tyre edhe deputeti socialist Bashkim Fino dhe kreu i Republikana-

nëve Fatmir Mediu. Fino në fjalën e tij veç të tjerash ka theksuar se qeveria aktuale në vitin 2013 ka trashëguar dosje të panumërta, rreth 9300 dosje të hapura pa një zgjidhje. Ndërkohë sipas tij, ligji ka pësuar ndryshime edhe gjatë qeverisjes së PD duke u shprehur në replikë ndaj Bylykbashit se qeveria aktuale duhet t'i kthejë pronën

e tij në Durrës dhe se interesi i tij dhe i PD nuk shkon më larg vetes së tyre. Rezerva për këtë ndryshim shprehu edhe ish-kryeministri Berisha. "Të ndryshosh pas dy vjetësh nenin për të zgatur afatin, ndërkohë që nuk u ke dhënë asnjë kacidhe ish-pronarëve ky është dështimi total i radhës. Tani shpërbleni njëri-tjetrin me to", u shpreh Berisha.

### QËNDRIMI, BEN BLUSHI:

## "S'shkruaj për PD, alternative imë është kundër varfërisë"

Topalli: Qytetarët ikin për faj të qeverisë, jo të opozitës



Deputeti socialist Ben Blushi i është përmbajtur edhe dje për të tretën javë me rradhë, premtimit të tij për të kritikuar ata sektorë të ekonomisë të cilat krijojnë pakënaqësi për qytetarët. Blushi qartësoi kolegët e tij demokratë, teksa i ka sqaruar se kritikën e tij nuk i bën për të favorizuar të djathtën por për të ofruar alternativa të tjera për qeverinë e tij. "Jam i bindur se ka më shumë mundësi për të garantuar më tepër harmoni. Janë 400.000 vetë që jetojnë me 400 lekë. Për këtë më vjen turp. Kjo shumicë ka më shumë mundësi që të nxjerrë 400.000 vetë nga tortura. Janë këta që kërkohet azil. Propocioanalisht duhet të shpërndajmë më shumë për ta. Kjo shoqëri ka për të falimentuar nëse nuk mëson që të bashkëjetojë me të 400.000 të varfrit." u shpreh Blushi. Deputeti socialist i është përgjigjur edhe kolegut të tij për kritikën e një seance më parë Eduart Bejko. "Unë jam pjesë e grupit ku jam zgjedhur dhe besoj se lufta kundër varfërisë nuk është për të pasuruar të varfrit duke pasuruar

të pasurit. Ne sot nuk na kërcënojnë luftërat, por varfëria, Mendojmë se duhet të bëjmë një zgjedhje duhet të ndihmojmë më shumë ata që janë në nevojë. Do të jenë vetëm e vetëm me ata që na sollën në pushtet dhe me ata që janë në nevojë", u shpreh deputeti i PS. Lidhur me kandidatin e Kukësit Hasan Halilaj për të cilin Blushi ka bërë një shkrim, deputeti theksoi se ai vijon të jetë produkt i PD. "Hasani është produkti juaj, edhe kjo punë e di si është? Ju e kishit pandofël ne e bëmë kapele...po prap është produkti juaj", tha Blushi. Ndërkohë që ish-kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli e ka konsideruar seirxhi deputetin Blushi duke ja futuruar edhe atij problemet e mazhorancës. "Blushi nuk është i sinqertë. Ti i dije kandidatat e PS për deputetet në 2103, po nuk fole në atë kohë. Gjatë kësaj kohe ke qenë dëshmitar i heshtur dhe sehirxhi. Në 2013 nuk fitoi PS, sa kishit po aq vota sa në 2009. Fituesi ishte Ilir Meta, ai 3- fishi votat e veta, pikërisht ai që u zu me bllok në dorë", u shpreh Topalli.



### PD: Sulmuesi militant i PS, foto me Majkon

— Incidenti ndaj liderit të opozitës Basha gjatë takimit elektoral në Ersekë u bë objekt i një sërë reagimesh nga strukturat e PD dhe ngjalli debate në seancën e djeshme në Kuvend. Zëdhënësja e PD Orjela Nebiaj e cila akuzoi se i riu që tentoi të sulmonte me karrige Bashën në Ersekë është militant i majtë dhe këtë sipas saj e tregojnë fotot që ai ka me deputetin e PS Pandeli Majko



### Akuza e opozitës: PS orkestroi incidentin

— PD dënon dhunën sipas saj në prezantimin e kandidatit të opozitës në Kolonjë, ku sipas saj një person i njohur për lidhjet e tij me pushtetin, hodhi një karrige në drejtim të qytetarëve duke plagosur Fuat Mydinin 65 vjeç. Mos distancimi ndaj këtij sulmi nxjerr zbuluar autoritet e porositësit janë të njëjtët që kanë frymëzuar akte dhune edhe në qytete të tjera kundër opozitës.

# I moshuari: Karrigia ishte në drejtim të Bashës, goditi mua

## Fuat Mydini: Jam mirë, Liçon e njoh, jemi afër fshatit ku jetoj

### PS, kandidati

#### Malo: Ne e dënojmë incidentin. Do fitojmë



■ Reagon kandidati i majtë Arben Malo. "Shprehim indinjatën tonë për incidentin e ndodhur në takimin e kreut të opozitës Basha. Ne distancohem i rreptsisht nga çdo akt dhune apo gjest i pahijshëm. Çdo akt vandalizmi s'ka e s'do ketë mbështetjen nga asnjë strukturë e LSI, PS dhe e gjithë aleancës sonë. Ne besojmë dhe politika ndërtohet dhe jo denigruet dhe ne synojmë të bashkojmë e jo ndajmë qytetarët. Synojmë që qytetari të ketë besim të politika, jo të skandalizohet nga gjeatë të tilla. Kolonja, djepi i dijes e Rilindjes Kombëtare, jemi historikisht e politikisht kundër sjelljeve të tilla. Do bëjmë një fushatë qytetare dhe qytetarët do na vlerësojnë me 21 qershor për etikën tonë politike e programin që ne ofrojmë. Mbështetimi forcat e rendit e sigurojmë të gjithë qytetarët që përfaqësojmë filozofit punë jo shtesë politike, përballimi me ide, jo me justifikime, jemi progresiste dhe jo përdorim politik të rasteve sporadike si ai që ndodhi e u përdor nga opozita. Jemi të bindur për mbështetjen e qytetarëve me 21 qershor në mbarë Shqipërinë", thotë Malo.



### Njoftimi

## Policia: Suel Liçon arrest në flagrancë

— Arrestohet njeriu që shkaktoi incidentin në mitingun e Bashës në Ersekë, duke shënuar në këtë mënyrë përgjigjen e shpejtë të policisë. Kështu, nga ana e Specialistëve të Seksionit të Krimeve, në Komisarariat e Kolonjës dy netë më parë u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit Suel Liço, 27 vjeç, banues në fshatin Taç-Ersekë. Arrestimi ndaj tij u bë pasi: Mbrëmjen e djeshme në qytetin e Ersekës, gjatë takimit që ka pasur Subjekti Politik PD, shtetasi Suel Liço ndodhej në një lokal. Në gjendje të rënduar psikologjike, ka kapur një karrige dhe e ka hedhur, (jo në drejtim të podiumit) ku për pasojë është goditur shtetasi F.M., 74 vjeç, banues në Ersekë. Shtetasi F.M u mjekua në spitalin e Ersekës, jashtë rrezikut për jetën. Materialet i kaluan Prokurorisë të rrethit Gjyqësor Korçë, për veprën penale "Plagosja e rëndë me dashje"parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal.



I moshuari që u plagos dje në incidentin në Ersekë

Incidenti i ndodhur dy ditë më parë në Ersekë komentohet në mënyra të ndryshme nga ana e palëve politike, ndër-kohë që ka dhënë versionin e tij dhe vetë i dëmtuari, që nuk i ka lëvizur një presje akuzave të kryetarit të tij Luzlim Basha. Kështu, 74 vjeçari Fuat Mydini i cili u plagos me karrige në kokë nga 27 vjeçari Suel Liço, thotë se i riu kishte objektivin liderin e opozitës Luzlim Basha. Pas daljes nga spitali, i moshuari ka rrefyer versionin e tij për incidentin gjatë tubimit elektoral të demokratëve. "Ishte në takimin e Bashës ndërsa gjatë fjalës së tij ka fluturuar një karrige dhe më ka zënë në kokë. Unë isha shumë afër Bashës kur ai po fliste. Karrigia është hedhur në drejtim të tij por më zuri mua në kokë. Aktualisht jam në gjendje të mirë, nuk kam probleme me shëndetin. Liçon e njoh pasi jemi afër fshatit ku jetoj.

Unë nuk kam pasur asgjë me Liçon", përfundon 74-vjeçari. Në spital atë e ka vizituar edhe kryedemokrati Luzlim Basha, i cili i ka uruar shërim të shpejtë, ndërkohë që nuk ka përmbytur deklaratat politike, sipas të cilave kjo qeveri po

ushtron dhunë ndaj opozitës. Ndërkohë që 27-vjeçari nga Erseka i cili dyshohet se ishte në gjendje të rënduar psikologjike, u arrestua në flagrancë nga Policia e Kolonjës për sulmin me karrige ndaj liderit të opozitës në takimin

elektoral që Luzlim Basha mbajti në Ersekë për prezantimin e kandidatit për Bashkinë e këtij qyteti Viktor Duko. Incidenti elektoral, i cili nuk është i pari për demokratët pas atij që u shënua në Durrës, ndodhi mbrëmjen e së mërkurës, kur i riu Suel Liço banues në fshatin Taç të Ersekës hodhi karrigen në drejtim të vendit ku ndodhej Basha dhe drejtues të tjerë të takimit, por duke lënduar

një nga militantët që ndodhej pranë kryedemokratit. Karrigia e hedhur goditi një të moshuar, 74-vjeçarin Fuat Mydini i cili mbeti i lënduar dhe u dërgua në spital. Pas marrjes së mjekimit, i moshuari ka rrefyer versionin e tij për incidentin gjatë tubimit elektoral të demokratëve ku tha se i riu kishte objektivin liderin e opozitës Luzlim Basha. Ndërkohë që PD paralajmëroi dyshen Rama-Meta se çdo përpjekje apo presion kriminal i frymëzuar dhe i paguar nga kjo dyshe, s'do arrijë kurrë të mposhtë vendosmërinë plebishitare të qytetarëve shqiptarë për të dhënë gjykimin e merituar.

# Paloka: Sulmuesi militant i PS Meta: Ashpër ndaj përgjegjësve

## PD spekulon me incidentin, kryeparlamentari: Të merren masa



Incidenti gjatë takimit elektoral të liderit demokrat Basha në Ersekë u debutuar dje në seancë. Kreu i grupit parlamentar të PD Edi Paloka akuzoi se i riu që qëlloi me karrige në drejtim të vendit ku ndodhej kryedemokrati Basha, është militant i PS. "U quajt sherr midis vetë militantëve të PD, por personazhi që ka kryer aktin është jo vetëm militant i PS por i lidhur në hallka të ndryshme të pushtetit. Patë reagime zyrtare të turpshme pro që tregojnë se kush janë ata që e kanë orkestruar. U tha se ai ka dashur të qëllojë xhaxhin e tij, akte të tilla tregojnë se kjo qeveri, kryetari i kësaj qeverie ka nisur një rrugë që vetëm në drejtimin e duhur nuk është. Me këto akte vënë përballë

një realiteti që nuk i pëlqen e dinë që në 21 qershor do të përballen me revoltën qytetare dhe për këtë arsye po bëjnë çdo përpjekje edhe me dhunë", tha Paloka. Menjëherë kryeparlamentari Ilir Meta kërkoi masa të ashpra ndaj përgjegjësve të këtij incidenti. "Edhe unë do doja të bashkohesha me këtë shqetësim. Nuk dua të vë në diskutim që ka ndodhur një ngjarje e rëndë përderisa është konfirmuar nga PD që organizoi mitingun. Besoj se të gjithë jemi dakord që të merren masat më të ashpra ndaj personave përgjegjës dhe çdo akt tjetër që cenon rregullat e një fushate të ndershme dhe që cenon të dëmtojë çdo qytetar aq më tepër kur bëhet fjalë për aktivitetet të tilla", tha Meta.

**SHOQËRIA PËRMBARIMORE "KODRA BAILIFF SERVICE" sh.p.k**  
NJOTIMI PËR SHITJE NË ANKAND

Më datë 20.05.2015, në ora 16:00 (të Merkurën), zhvillohet ankandi i parë për shitjen e kolateralit të Fondi "Besa" sh.a, për një kredi të pakthyer:

**Kolaterali është:**  
- Tokë are, me nr. Pasurisë 402/1, vol 10 faqe 206 e ndodhur në zonën kadastrale 3051 me sipërfaqe 1500 m<sup>2</sup> në fshatin Priskë e Madhe në pronësi të Amet Sali Shkalla i dti 12.10.1960.

**Cënimi me të cilin fillon ankandi i parë është 240,000 (dyqind e dyzetë mijë) lekë.**

Ankandi do të qëndrojë i publikuar nga data 05.05.2015 deri në datë 20.05.2015 dhe zhvillohet në këtë datë në përfundim të orarit zyrtar (ora 16:00).

Afati i fundit për pranimin e ofertave do të jetë data 20.05.2015, ora 16:00 në ambientet e Shoqërisë "KODRA BAILIFF SERVICE" sh.p.k, me adresë: Rruga "Frederik Shiroka", Kulla 3, Shkalla 3, Zyra 4, Tiranë.

E-mail: info@kodrabailiff.com Tel: +355 699381888

# Veliaj, investitorëve vendas dhe të huaj: Do vlerësoj çdo ide

## Kandidati i majtë: S'ka më leje ndërtimi në Bllok. I rikthehemi projektit të parë për bulevardin

**“M**arrëdhënie e bashkëpunimi midis bashkisë e biznesit, që do bazohet mbi transparencën e partneritetin”. Me këto fjalë e ka nisur dëgjuesën me investitorët shqiptarë e të huaj, kandidati i koalicionit të majtë për Bashkinë e Tiranës, Erion Veliaj, që ka prekur disa nga

problemet që shqetësojnë sot sipërmarrjen. “Do themelohet një Këshill Ekonomik për Tiranën, sipas modelit të Këshillit Kombëtar të Punës, ku do adresojmë të gjitha problemet e kërkesat e biznesit të lokalizuar në kryeqytet. Vlerësoj bashkëpunimin që kemi pasur me biznesin në 18 muajt e fundit e dëshiroj që këtë bashkëpunim ta shtrij dhe në Bashkinë e Tiranës.

Për këtë, kam propozuar ngritjen e këshillit ekonomik në bashki. Ndërkohë, mirëpres çdo ide që mund të kenë për këtë bashkëpunim”, tha Veliaj. Ai ka ofruar garanci për biznesin për ta trajtuar atë si një partner në zhvillimin e qytetit, ku theksoi se praktikisht më të mira të zbatuara në ministrinë e Mirëqenies do t'i zbatohet edhe në Bashki, si buxhetimi

që këtë vit i fondit të caktuar për nxitjen e punësimit dhe hapjen e zyrave të punës. Ndërsa biznesi kërkonte klimë më miqësore, mbështetje e shmangien e konflikteve politike, që sipas tyre ndikojnë direkt te sipërmarrja. Veliaj i ka cilësuar të lodhshme dhe të panevojshme procedurat që u duhen bizneseve për t'u regjistruar apo paguar taksat, duke premtuar heqjen e

këtyre barrierave. Ai tha se Tirana ka mundësi të zgjerohet, të punësojë njerëz dhe se do t'i rikthehemi projektit të parë për zgjerimin e Bulevardit. “Këtu ka interes shumë të madh publik për hapësirat e gjelbra. Ne nuk inspirojmë të japim leje ndërtimi në Bllok, siç po bëh bashkia aktuale. Do i rikthehemi projektit për ndërtimin e bulevardit por me projektin e parë, duke ruajtur proporcionin e barit me betonin. Ne do vijojmë nxitjen e ndërtimit por jo në ato zona ku janë të mbytura nga ndërtimet. Po me proporcionin e barit me betonin si në variantin e parë, ku respektohet qartë hapësira publike, ndryshe nga plani i dytë i bashkisë. Do ketë një rikthim të Bulevardit të ri, me më shumë hapësira të gjelbra, por dhe me më shumë hapësira për t'u zhvilluar, gjithmonë jashtë Tiranës”, tha ai. Sipas tij, nuk do ketë më betonizim të Tiranës sepse do të bëhet një ndarje e qartë e zonave të ndërtimit me zonat ku jetohet, në mënyrë që qytetarët të mos ndihen të rrethuar nga betoni. Duke i rikthyer shqetësimeve të biznesit për kontrollin e tregjeve, Veliaj tha se do të bëhet një certifikim i ushqimeve bio. Shqetësimi për turizmin iu përgjigj se me ndarjen e re territoriale Tirana “përfitoi” 13 kala, do rikthehet Pazarit e Ri në stilin e vet tradicional, për të pasur një lloj hapësire feste e shërbimeve kulinarë tradicionale të zonës, do t'i jepet prioritet parkut të Dajtit e gjithë zonës së malësisë së Tiranës, për një turizëm ndryshe, me aventura. Ai premtoi audit të bashkisë, për transparencë.

**Projekti**  
“I rikthehemi projektit të parë për ndërtimin e bulevardit, duke ruajtur proporcionin e barit me betonin. Do vijojmë nxitjen e ndërtimit, jo aty ku janë mbytur nga ndërtimet”




**VELIAJ:**  
“S’premtoj çudira, s’fshihem si Basha”



— Kandidati i majtë për Bashkinë e Tiranës Erion Veliaj në takim me banorët të Njësisë 11 vuri në dukje se ende pa u ndryshuar kreu i Bashkisë, administrata aktuale është larguar nga Tirana duke u përqendruar në Kamzë. “Kanë dezertuar Tiranën, se thonë e kemi të humbur, të paktën të marrim Kamzën”, tha Veliaj. Ai vuri në dukje se ai nuk premtonte çudira ashtu si Basha i cili tashmë fshihet nga qytetarët e Tiranës. “Nuk premtoj çudira si trami apo shpërbllimi për gol. Luli fshihet në Tiranë se i thonë ku e keni Tramvajin dhe sa lek ke dhënë për sportin”, tha Veliaj që duke u ndalur te sporti tha se përveç ekipit të Tiranës do ndihmohen dhe ekipet e tjera të kryeqytetit.

# PD, Kosova: Bashkia Tiranë nuk do ndikim nga politika

## Demokratët padisin Dakon në Durrës: Manipulon me listat



**K**andidati i PD për Tiranën, Halim Kosova deklaroi se Bashkia e Tiranës nuk duhet të ndikohet nga politika, por nga halli i qytetarëve. “Ne do bëjmë një Bashki që mos ndikohet nga politika, por të ndikohet nga halli i qytetarëve. Shembulli më i qartë se si politika mund të dëmtojë qytetarin e vetë, se si politika mund të bëhet pengesë, është mosmbledhja e Këshillit Bashkiak për t'u dhënë sipas listës apartamentet falas”, ka thënë Kosova gjatë një takimi me komunitetin rom në zonën e pallatit me shigjeta, të cilët vuajnë mungesën e strehimit. Në këtë komunitet Halim Kosova u angazhua se do t'i japë zgjidhje përfundimtare kësaj çështjeje që vijon tashmë prej vitesh. Kosova tha se ky komunitet duhet të organizohet dhe kërkohet të drejtat e tyre. Ai u ndal edhe në zonën e Medresesë dhe Laprakës ku sipas tij ndihet rënia e konsumit dhe varfërisë. Ndërkohë gjatë takimit të tij me banorët e zonës së Laprakës ai u shpreh se: “Qyteti i Tiranës ka nevojë për ndeshje të bukura, ka nevojë për ballafaqime frytdhënëse, ka nevojë për të prekur jetën e çdo qytetari dhe mos ndahesh nga problemet që ka ai”.



**KALLËZIM DAKOS**  
PD deponoi në Prokurorinë e Përgjithshme kallëzim penal ndaj kreut të Bashkisë së Durrësit Vangjush Dako, të cilin e akuzon se po tenton të manipulojë zgjedhjet e 21 qershorit përmes shtimit të emrave në listat e zgjedhësve. Deputeti Edmond Spaho dhe Arben Ristani pas daljes nga prokuroria deklaruan për mediat se kërkuan nga prokuroria hetim të menjëhershëm dhe heqjen e 2700 personave të regjistruar gjatë prillit në qytetin e Durrësit. Për të vërtetuar akuzat ndaj Dakos dhe vartësve të tij PD ka deponuar në prokurori edhe provat përkatëse. Ndërkohë deputeti Arben Ristani i cili në vitin 2011 ishte në krye të KQZ kur PS e akuzoi se i dha fitoren në tavolinë Lulzim Bashës, si për ironi të fatit bëri të njëjtën deklaratë.

**Laparakë**  
“Qyteti i Tiranës ka nevojë për ndeshje të bukura, ka nevojë për ballafaqime frytdhënëse, për të prekur jetën e çdo qytetari dhe mos ndahesh nga problemet që ka ai”

**SHPALLJE ANKANDI**  
**SHOQËRIA PËRMBARIMORE “ARDAEL”** shpk, shpall shitjen në ankand të parë për pasurinë nr.6/182+1-22, ZK.8190, Kompleksi Grand,Tiranë, me çmim fillestar **4,635,232 (katër milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e dy) Lekë**. Ankandi zhvillohet në datë **18.05.2015 ora 15:30**.  
Personat e interesuar mund të kontaktojnë në numrin: **0672027883**;  
email: ardael2004@yahoo.com; web: www.ardael.com ose në adresën Rr. “Xhorxh W Bush”, Kulla 1, Kati I, poshtë lokal Elizes, përballë Parlamentit, Tiranë.

**SHPALLJE ANKANDI**  
Shoqëria Përmbarimore “616/A” shpk, shpall shitjen në ankandin e dytë për pasurinë “Trull + Ndërtëse”, me sip. 120 m<sup>2</sup>, nga te cilat 120 m<sup>2</sup> Ndërtëse, me numër pasurie 3/392, vll.15, fq.82, zk.8561, me adresë Lagjia nr. 10, Rruga “ Niko Kovaci”, Korçë.  
Pasuria nxirret në ankand me vlerën fillestare 6.048.000 (gjashtëmilion e dyzet e tetëmijë) Lekë. Ankandi zhvillohet në datë 04.06.2015.  
Personat e interesuar mund të paraqiten në adresën Lagjia nr.3, Rruga «Naim Frashëri», Pogradec ose të kontaktojnë në numrin 069 72 51 504 ose në e-mail: shoqeria616a@gmail.com



## Problemet me mbiemrin, detyrojnë të regjistrohet sërish KQZ refuzon dokumentat e Dumës nuk e regjistron si kandidatë

**K**omisioni Qendror i Zgjedhjeve ka refuzuar të regjistrojë dje kandidaten e Partisë Demokratike për Bashkinë e Durrësit, Grida Duma. Sipas anëtarëve të KQZ-së, arsyeja e kthimit të dokumentacionit është bërë mbiemri i saj, pasi në dokumentet figuronte me dy mbiemra. Gjatë mbledhjes ka pasur debate për mbiemrin e kandidatës së të djathtëve, pasi ajo

ka kërkuar të regjistrohej me dy të tillë (Grida Duma Shqina). Në mbledhjen e djeshme të KQZ-së, janë pranuar dokumentacionet dhe janë regjistruar në zgjedhje Voltana Ademi për PD në Shkodër, Genc Deromemaj për PD në Vlorë, Darien Xhindoli për PD në Lushnjë, Fatos Tushe për PS në Lushnjë, Sotiraj Filo për PS në Korçë, Xhelal Mziu për PD në Kamëz, Gjergj Mero për

PD në Korçë, Fran Frrokaj për PD në Lezhë, Keti Bazhdarin për PS në Shkodër, Armando Subashin për PS në Fier, Vangjush Dako për PS në Durrës. Dje janë regjistruar zyrtarisht edhe dy kandidatët për Tiranën, Erion Veliaj dhe Halim Kosova. Në garën për Tiranën është shtuar edhe një tjetër kandidat i propozuar nga partia e Mark Frrokut, Dhimit Muslia.

LAJME shkurt



### PLL dhe Balli Kombëtar drejt ikjes nga koalicioni i PD

Në prag të zgjedhjeve vendore të qershorit, duket se Partia Demokratike do të braktiset edhe nga dy aleatë të tjerë të saj. Bëhet fjalë për aleatët historikë të së djathtës përkatësisht Partia "Lëvizja e Legalitetit" dhe Partia e Ballit Kombëtar. Dy partitë e akuzojnë Partinë Demokratike se në mënyrë të njëanshme nuk ka plotësuar kushtet thelbësore të marrëveshjes dypalëshe. Pavarësisht se këto dy parti nuk kanë asnjë përfaqësues në parlament, që të dyja kanë nënshkruar me partinë më të madhe të opozitës në të cilën përcaktohen modalitetet, por pavarësisht kësaj kushtet nuk janë zbatuar ende.



### Kuvendim 650 mln lekë për partitë në zgjedhje

Mazhoranca e opozita pavarësisht se debatuan gjatë me njëra-tjetrën për çështjet që kishin në mendin e ditës, gjetën konsensus për paratë që kalojnë drejt partive politike. 83 vota nga shumica dhe opozita mori Projektvendimi "Për miratimin e fondit nga buxheti i shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet vendore të vitit 2015. Ky fond për partitë politike, pritet të jetë rreth 650 milionë lekë dhe do të shpërndahet mes partive politike. Pikërisht nga ky fond mund të përfitojnë të gjitha forcat politike që në zgjedhjet e fundit kanë arritur të marrin 0.5 përqind të votave. Por këto përlogaritje dhe ndarjen e tyre do t'i bëjë KQZ.

# Rama: Pandeli Majko njeriu që legalizoi Erion Veliajn në PS

## Deputeti i kujton kandidatit të PS se Rama e sheh si ndërtim pa leje

JUXHIN MUSTAFARAJ  
TIRANË

**K**ryeministri Edi Rama ka mbështetur dje kandidatin e mazhorancës për Bashkinë e Tiranës, Erion Veliaj. Rama shprehu bindjen se vetë Veliaj nën drejtimin e Bashkisë së Tiranës do të bëjë më shumë seç edhe ai vetë bëri gjatë drejtimit të atij institucioni. "Vota shprehje e ambicies që çdo person ka për qytetin e tij, për shërbimin që ai do të ofrojë. Duke votuar Erionin më 21 qershor do të jenë shumë e shumë më tepër njerëz që do ta shohin këtë si model suksesi. Do të bëhet shumë

**PD**  
Në këto zgjedhje është ta çosh votën dem të votosh për PD. Si mund t'i mbështesim ne kryetarët e Bashkive të PD, kur ata kanë frikë se i shohin

edhe më shumë për se çfarë bërë unë për Tiranën. Pasi Erioni do të ketë në krah një qeveri që do ta mbështesë. Për 4 vite Bashkia e re do të jetë një model suksesi. Më i suksesshëm se modeli që solla unë në Tiranë", deklaroi kryeministri. Rama e cilëson si të çuar dem votën e hedhur për Partinë Demokratike në zgjedhjet e ardhshme lokale të 21 qershorit. Sipas tij kjo pasi PD kërkon votat që të mos i lënë kryetarët e saj që të bëjnë punën për ta përdorur si justifikim për të rrëzuar qeverinë. "Në këto zgjedhje është ta çosh votën dem po të votosh për PD. Si mund t'i mbështesim ne kryetarët e Bashkive të PD, kur ata kanë frikë se i shohin. Edhe ata që janë trima nuk kanë frikë se i shohin. PD po kërkon votën që të mos i lënë që të bëjnë punën për ta përdorur si justifikim për të rrëzuar qeverinë", tha kreu i qeverisë. Gjatë shpërndarjes së lejeve të legalizimit, kryeministri Rama nuk i kurseu batutat edhe për deputetin e qarkut të Tiranës, Pandeli Majko. Sipas Ramës, Majko është personi që "legalizoi" Erion Veliajn në Partinë Socialiste, pa të cilin ky i fundit nuk do të ishte i njëjti. "Pandeli Majko futi Veliaj në PS. Legalizimi që i bëri Pandi duke e futur në PS është një ogur i mirë. Kush ka lidhje shpirtërore me Pandin ka vetëm mirë", u shpreh me humor Rama. Ndërkohë që vetë deputeti Majko iu përgjigj se edhe Veliajn, Rama e cilëson si ndërtim pa leje, por e vërteta sipas tij është se së bashku kanë ndikuar të kandidati i së majtës për Bashkinë e Tiranës. "Unë edhe Edi jemi njerëzit që bëmë këtë Erion që shkoi sot. Edi bërë katin e parë, unë të dytin", deklaroi Majko.



### Mbështetja

#### Mandati

Duke votuar Erionin më 21 qershor do të jenë shumë e shumë më tepër njerëz që do ta shohin këtë si model suksesi. Do të bëhet shumë e më shumë për se çfarë bërë unë për Tiranën

#### Zgjerimi

Do merrni legalizimet falas e do jeni nën catinë e pronës tuaj. Unë si katunar i Dajtit e mbështes plotësisht e ne si Dajt mezi prap të bashkohemi me Tiranën e të jemi pjesë e bashkisë.

### Batutat

## Artan Lame: Ende na hanë duart për kryeqytetin



**LAME:** Punën do ta vazhdojmë zoti Kryeministër. Gjithë ky staf me 15 drejtoritë vazhdojnë ti hajne duart për ta mbaruar këtë punë

**RAMA:** Mesa duket edhe organizimi sot është bërë për të kujtuar se PD ju ka lënë gjithë këto vite në diell, është dita e fundit që do rini në diell. Do merrni legalizimet falas e do jeni nën catinë e pronës tuaj të patundshme. Unë si katunar i Dajtit

e mbështes plotësisht e ne si Dajt mezi pres të bashkohemi me Tiranën e të jemi pjesë e bashkisë.

**MAJKO:** As ç'ta kemi nxi ne sot jetën këtu në diell, por s'ke ç'a bo. Ne të majtë jemi njisha për të nxirë jetën  
**RAMA:** Unë nuk është se e trajtova Erionin si godinë pa leje por desha të them kush e legalizoi. Legalizimi që i bëri Pandi duke u bërë pjesë e PS-së ka qenë një ogur shumë i mirë"



**DEKLARATA**

**Duke ju drejtuar qytetarëve të pranishëm, Rama tha se janë 1001 leje legalizimi falas që do të shpërndahen për familjet**

**LORENC RABETA**  
TIRANE

**K**ryeministri Edi Rama shpërndau dje 1001 leje legalizimi në Tiranë, duke theksuar se në këtë proces do të përfshihen edhe objektet e ndërtuara pas vitit 2009. Sipas kryeministrit në total 60.000 objekte të ndërtuara pas vitit 2009, të cilat përjashtohen nga një nen i ligjit aktual të legalizimit. "Janë 60.000 ndërtime, për të cilat para 7 vitesh u fut një nen që i përjashtonte ndërtimet e reja nga procesi i legalizimeve. Ne kemi marrë nismën që edhe për këto ndërtime të nisim procesin e legalizimit"- theksoi Rama.

**1001 LEJE**

Duke ju drejtuar qytetarëve të pranishëm, Rama tha se janë 1001 leje legalizimi falas që gjenden në këto dosje dhe që do të shpërndahen për familjet. Ai shoi se shifrat janë kokëforta dhe flasin vetë për seriozitetin e qeverisë, në realizimin e një premtimi elektoral, siç ishte legalizimi i banesave falas. "U thonë njerëzve që Rama iu mashtroi se nuk ka legalizime falas. Jeni dëshmitarë se kur keni paguar para nën dorë dhe keni marrë vetëm diellin

mbi kokë, sot merrni lejen e legalizimit falas. Këta që ju morën për budallenj gjithë këto vite, si ka mundësi që ju kujtojë si dele që t'iu marrin dhe t'iu çojnë në vathët e Berishës. Këtë pyetje ua bëj atyre që e kanë votuar dhe do të votojnë prapë PD. Shumë njerëz në këto aktivitet na thonë faleminderit ne. Ne bëjmë detyrën, duhen falënderuar ata qytetarë që votuan pro nesh që ne të

vinin në pushtet për të bërë detyrën. U deshën 6 muaj për të gjetur se ku ishin lënë dosjet. Ishin në një magazinë pa inventar" theksoi Rama. Sipas Kryeministrit, në 1 vit ALUIZNI ka bërë aq sa nuk është bërë në 8 vite marrë së bashku. 50.000 objekte më shumë të përditësuara pas matjeve. Në 1 vit 25.000 legalizime, ata në 8 vite bënë vetëm 21.000. Sot arrijmë në 27.500 legalizime në më shumë se 1

vit. "Brenda mandatit legalizojmë një pjesë dërrmuese në zonat informale falas. Në 8 vite 4503 legalizime në Tiranë. Shumica biznese. Mes tyre biznese të ndërtuara në zonat më të rëndësishme. 5847 në 1 vit nën drejtimin e Artan Lamajt. Janë 60.000 ndërtime, për të cilat para 7 vitesh u fut një nen që i përjashtonte ndërtimet e reja nga procesi i legalizimeve. Ne kemi marrë nismën që edhe për këto ndërtime të

nisim procesin e legalizimit. Nuk ka më ndërtime pa leje ashtu siç ka pasur. Ata që kanë ndërtuar për një shpi në zonat informale, asnjë nuk do e lëmë rrugëve" shtoi Rama.

**EKONOMIA**

Më tej Rama theksoi se ne do vijojmë në drejtimin e duhur, Shqipëria po hyn në rrugën e rimëkëmbjes ekonomike sociale. Kthesa falë reformave që ne po bëjmë.

"Reformat janë operacione të vështira. Kur bëhet fjalë për betejën mes jetës dhe vdekjes, prindërit nuk e çojnë në operacion fëmijën për ta torturuar, por për ta shpëtuar. OSHEE nuk do të kërkojë nga lekët që i duhen komunitetit për të mbushur gropën e atyre që nuk paguajnë. Këto para janë investime që i shkojnë përsëri njerëzve. Kush paguan energjinë kryen një akt patriotik" tha Rama.



**50.000 objekte**

Në 1 vit ALUIZNI ka bërë aq sa nuk është bërë në 8 vite marrë së bashku. Kryeministri theksoi se janë 50.000 objekte më shumë të përditësuara pas matjeve

**25.000 legalizime**

Në 1 vit u realizuan 25.000 legalizime, ndërkohë që qeveria e shkuar në 8 vite bënë vetëm 21.000. Sot arrijmë në 27.500 legalizime në më shumë se 1 vit

**5847 në 1 vit**

Në 8 vite 4503 legalizime në Tiranë. Shumica biznese. Mes tyre biznese të ndërtuara në zonat më të rëndësishme. 5847 në 1 vit nën drejtimin e Artan Lamajt

# Edi Rama: Do legalizohen 60 mijë ndërtime pas vitit 2009

## Kryeministri shpërndau 1001 leje për objektet në kryeqytet

**RAPORTIMI**

# Blokim e konfiskim 1500 lojërash fati

Ministria e Financave: 144 gjobë ndaj subjekteve në vlerën e 720.000 USD

**N**jësia e Mbiqyrjes së Lojërave të Fatit (NJMLF) në Ministrinë e Financave, raporton tregues në rritje të performancës së saj. Sipas Ministrisë së Financave, tashmë e tërë atë histori e "zezë"

e lojërave pa "rregulla loje", të abuzimeve e shmangieve, e evazionit e mashtimit tatumor, që u bë një realitet i dhimbshëm në Shqipëri, ku ekziston qindra kompani fantazëm lojërash fati, e ku organizoheshin në mënyrë

të paligjshme veprimtari biznesi, tashmë është duke u treguar vetëm si një histori. Referuar të dhënave zyrtare për periudhën Tetor 2013 – Prill 2015, janë kontrolluar 6500 pika sekundare lojëra fati; janë konstatuar 1709 shkelje ligjore në fushën e lojërave të fatit; janë plot 144 masa administrative me gjobë ndaj subjekteve të lojërave të fatit në vlerën e 720.000 USD. Gjatë së njëjtës periudhë më shumë se 1500 aktivitetet lojërash fati të paligjshme janë bllokuar dhe konfiskuar, ndërsa

1149 automate elektronike janë konfiskuar. Sipas informacionit nga NJMLF aktualisht ndaj 9 subjekteve të licencuara është

**6500 pika**  
Referuar të dhënave zyrtare për periudhën Tetor 2013 – Prill 2015, janë kontrolluar 6500 pika sekundare lojëra fati; janë konstatuar 1709 shkelje ligjore

marrë masa administrative "pezullim aktiviteti", ndërsa masa administrative "bllokim i logarive bankare" është marrë ndaj 35 subjekteve të licencuara; Po kështu u është hequr licenca 20 subjekteve të licencuara.

Në vijim të kontrolleve specifike dhe zbatimit të masave të aplikuara janë zhbllokuar në favor të shtetit fondet e ngurtësuar të garancisë ndaj 15 subjekteve, të cilët kanë rezultuar debitorë ndaj NJMLF dhe DPT në vlerën 650.000 USD. Nisur nga shkeljet e vërejtura

në raport me ligjin dhe aktet e tjera nënligjore, njësia përkatëse në Ministrinë e Financave ka plotësuar dosjet dhe ka dërguar për ndjekje penale mbi 40 persona. "NJMLF ka ndërmarrë masa shtrënguese, si dhe ka nisur procesin e kërkimit të pasurive të subjekteve debitorë pranë ZRPP-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit. Në proces janë duke u vendosur barra siguruese ndaj disa automjeteve në pronësi të subjekteve debitorë" theksohet në një deklaratë zyrtare Ministria e Financave.

STUDIO PËRMBARIMORE "SPEED SOLUTION"  
**NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT 1 PËR:**

"Apartament", me sip 98.2 m<sup>2</sup>, me nr.pasurie 9/438+5-18, Z.k.8330 . Volumi 12, faqe 233, me regjistër hipotekor nr.738 datë 23.08.2007 me adresë Rr."Don Bosko", Tiranë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të RAIFFEISEN BANK sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **7,672,000 (shtatë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë ) Lekë.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **13.05.2015, Ora 16:00**, pranë Studios Përmbarimore "SPEED SOLUTION" me Adresë: Bulevardi "Gjergj FISHTA" Kulla.1, Kati. 2, Nr.3, Tiranë.

Për çdo informacion mund të kontaktoni cel. 0693041355,0696334695 email: speed.solution@yahoo.com

**TABELA MBI TË ARDHURAT E MBLEDHURA NGA NJMLF SIPAS VITEVE NJËSIA E MBIKËQYRJES SË LOJËRAVE TË FATIT**

ARKËTIME PËR NJMLF PËR PERIU DHËN 01.10.2013- 04.05.2015

Periudha	2011	2012	Deri 30.09. 2013	Nga 01.10 - 31.12.13	2014	Deri 04.05.2015
<b>Total i të Ardhurave</b>	<b>82,163,412</b>	<b>87,201,124</b>	<b>46,563,978</b>	<b>68,702,961</b>	<b>108,443,415</b>	<b>86,908,005</b>

**Marinza**

# Bankers: Do shpojme 11 puse të reja në Patos-Marinzë

## AKBN: Eshtë pezulluar çdo lloj kërkimi në zonë për dy vjet

**LORENC RABETA**  
TIRANE

**P**avarësisht nga dëmi i shkaktuar në zonën e Marinzës dhe presioni i shtetit e opinionit publik për të ndërprerë aktivitetin deri në bonifikimin e pasojave, kompania "Bankers Petroleum" nuk ka ndërmend ta pezullojë aktivitetin e saj. Në raportin e veprimtarisë gjatë tremujorit të parë të këtij viti, kompania njoftoi se planifikon të shpojë 11 puse horizontale gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015, nëntë puse horizontale në fushën e Patos-Marinzës, pikërisht aty, ku ndodhi edhe katastrofa mjedisore, një pus horizontal në Kuçovë dhe një pus horizontal për depozitim të ujit. "Bankers do të vazhdojë të zgjerojë programin e injektimit të polimerit dhe ujit me konvertimin e katër puseve të planifikuara në tremujorin e dytë. Shumica e konvertimeve të 2015-ës janë planifikuar për gjysmën e dytë të vitit, pas instalimit të pajisjeve", thuhet në njoftimin e kompanisë koncesionare kanadeze.

**Pezullimi**

**Dervishi**

Sipas AKBN, shpimet në Marinzë janë bllokuar tërësisht për një periudhë dy vjeçare, ndërkohë që është hapur një hetim i dytë ndaj "Bankers", dyshime për abuzime



**Dëmi**

Pavarësisht nga dëmi i shkaktuar në zonën e Marinzës kompania Bankers Petroleum nuk ka ndërmend ta pezullojë aktivitetin e saj, madje do shpojë 11 puse të reja



të ketë kryer të tjera abuzime në vitin 2012. Lidhur me shpërthimin e gazit në Patos-Marinzë, sipas kreu të AKBN në këtë zonë, nuk do të kryhen kërkime për të paktën një periudhë 2-vjeçare, afat i konsideruar si i domosdoshëm për rehabilitimin e mjedisit.

ionë dollarë (87.39 USD/ fuçi) gjatë tremujorit të parë 2014. Rënia e çmimit si

pjesë e përqindjes ndaj Brent kundrejt tremujorit të parë 2014 është kryesisht

si pasojë e shitjeve më të larta të naftës në tregun e brendshëm. Renta minerare paguar Qeverisë Shqiptare dhe institucioneve të varësisë gjatë tremujorit të parë 2015 ishte 10 milionë dollarë (14% e të ardhurave) kundrejt 16 milionë dollarë (15% e të ardhurave) gjatë tremujorit të kaluar dhe 22 milionë dollarë (15% e të ardhurave) gjatë tremujorit të parë 2014.

Të ardhurat e gjeneruara nga operacionet ishin 25 milionë dollarë gjatë tremujorit të parë 2015 kundrejt 23 milionë dollarë gjatë tremujorit të kaluar dhe 83 milionë dollarë gjatë tremujorit të parë 2014. "Kompania vijon të mbajë një pozicion të fortë financiar me likuiditete prej 58 milionë dollarë dhe kapital aktiv prej 174 milionë dollarë" thekson kompania në raport.

**AKBN**

Raporti i Bankers për zgjerimin e aktivitetit vjen në një çast kur Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka nisur një hetim të dytë ndaj aktivitetit të kompanisë, ndërkohë që ka vendosur pezullimin e çdo kërkimi

në zonë për një periudhë së paku dy vjeçare. Në një dalje të djeshme para shtypit, kreu i AKBN, Dael Dervishi, tha se hetimi i dytë është nisur për shkak të shtimit të dyshimeve se kompania mund

**FITIMET**

Sipas raportit të vetë kompanisë për rezultatet financiare gjatë tremujorit të parë 2015, të ardhurat ishin 72 milionë dollarë (39.66 USD/fuçi) kundrejt 109 milionë dollarë (57.29 USD/fuçi) në tremujorin e mëparshëm dhe 145 mil-

**Abuzimet me subvencionet**

## Panariti pezullon përgjegjësin e bujqësisë në Librazhd

— Përgjegjësi Rajonal për Bujqësinë në Librazhd Osman Terziu, është pezulluar nga detyra ditën e djeshme pas një takimi që Ministri Panariti dhe Deputeti Taulant Balla pati me fermerët në Librazhd. Disa fermerë denoncuan tek Ministri Panariti një rast korrupsioni të Terziut me subvencionet, ku punonjësi kishte vjedhur fondet për bujqësinë dhe nuk ua kishte shpërndarë ato fermerëve. Ky lajm është konfirmuar edhe nga deputeti Taulant Balla në rrjetin social Facebook.

Sipas deputetit ky rast korrupsion është denoncuar nga disa fermerë. "Falënderoj disa prej fermerëve që denoncuan edhe raste korrupsioni, në të shkuarën edhe gjatë vitit të kaluar. Ndaj një personi të akuzuar për korrupsion do inicijohet hetim dhe do ndëshkohet", theksonte në "Facebook" deputeti Taulant Balla. Ministri i Bujqësisë ishte në Librazhd inspektoi një vreshtari të standardeve evropiane në fshatin Togëz të Librazhdit e cila është subvencionuar nga shteti.



**"Unë dua një gazetë, me informacione mbi shëndetësinë"**

**Po ju si e doni gazetën tuaj?**

# KLSH kallëzon komisionin e ofertave, për tenderat në QSUT

Si rezultat i shkeljes është konstatuar dëmi ekonomik në 10,803,376 lekë

**N**ga QSUT vetëm për tenderin "Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë", që mbulon shërbimin janar-prill 2015, si pasojë e shkeljes së barazisë në tendera shtetit i është shkaktuar një dëm prej 10,803,376 lekë. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të tij të auditimit nr. 40/2, datë 14.01.2015, pasi ka ushtruar auditimin tematik në Qendrën

Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, ka dalë në përfundim se janë konstatuar një sërë shkeljesh të procedurës të prokurimit për tenderin me objekt "Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë" për shërbimin e kërkuar për periudhën Janar-Prill të këtij viti. Si rezultat i shkeljes së procedurës së vlerësimit të ofertave është konstatuar një dëm ekonomik në vlerën 10,803,376 lekë. Ndërkohë, nga auditimi është konstatuar

## Akuza

Për të gjitha shkeljet e konstatuara nga ana e grupit të auditimit, për zhvillimin e procedurës së këtij tenderi, KLSH ka depozituar pranë organit të Prokurorisë kallëzim

se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në zbatimin e procedurës së tenderit "Negocim pa shpallje paraprake të




njoftimit" për një fond limit prej 94,277,276.7 lekë pa t.v.sh për shërbimin e lavanderisë, ka s'kualifikuar padrejtësisht një operator pjesëmarrës në tender, me ofertë më të ulët se oferta e paraqitur nga operatori i shpallur fitues (diferenca 10,803,376 lekë). Me s'kualifikimin e këtij operatori ekonomik është shkëtur barazia e pjesëmarrësve në tendera publike dhe është favorizuar subjekti fitues, veprim që është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për prokurimin

publik" dhe VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Sa më sipër, për të gjitha shkeljet e konstatuara nga ana e grupit të auditimit, për zhvillimin e procedurës së këtij tenderi, KLSH ka depozituar pranë organit të Prokurorisë kallëzim penal ndaj punonjësve të QSUT, anëtarë të KVO-së L.S (kryetar), K.Q dhe A.T (anëtar), me akuzën "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal.

## Droga

Operacioni "Oxhaku", sekuestrohen 300 gr heroinë



■ Efektivët e policisë së kryeqytetit kanë bërë të mundur sekuestrimin e 300 gramëve lëndë narkotike të llojit "heroinë". Gjithashtu, në prangat e policisë ka rënë shtetasi Faqion Drenovci, i cili posedonte sasinë e heroinës. Sekuestrimi ka ndodhur në kuadër të të ashtuquajturit Operacioni "Oxhaku". Faqion Drenovci, i cili sipas policisë rezultoi edhe me precedentë të mëparshëm kriminalë, pikërisht për të njëjtën akuzë. Mësohet se ai ka qenë i dënuar edhe më parë për drogë nga viti 2005 deri në vitin 2010.

## NJOFTIMI I ANKANDIT



- Autoriteti shitës:** Albpetrol sha Patos, Rruga Fier - Patos km.7
- Data e zhvillimit të ankandit:** 08/05/2015
- Lloji i Procedurës standarde të ankandit:** Proedurë e hapur
- Objekti i Shitjes:** Shitje naftë brut, sasia 100,000 ton
- Afati i evadimit:** 365 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës
- Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes:** Shitje e naftës brut, sasia 100,000 ton, në pikat e lëvrimit CTF Marinëz (Bankers), Stacioni Kuçovë, Stacioni Usojë, 16/1 (ARMO) Ballsh, Stacioni Zharrëz, Stacioni Sheqishte, Stacioni Gorisht.

### 7. Vlera fillestare:

#### Në pikat e lëvrimit:

Çmimi minimal fillestar për njësi është:

72.52% e Çmimit Brent - 5.55 USD/bbl + K

- 72.52 është koeficienti i cili përfaqëson karakteristikat mesatare fiziko-kimike të naftës për sasinë prej 100 000 ton (pesha specifike, aciditeti i naftës, % e sqfurit).
- Brent është çmimi në \$/bbl i Brent(Dtd) i Platts.

Në rastin e pagesës në cash, për llogaritjen do të merret referenca e Brent në datën kryerjes së pagesës në llogarinë e Albpetrol sha.

Në rast të pagesës me Letër Credit (LC) për llogaritjen do të merret referenca e Brent i Platts, edhe i publikuar në Buletin e Prokurimeve Publike në datën e protokollimit të LC në protokollin e Albpetrol sha Patos për llogari të Albpetrol sha Patos.

- 5.55 USD/bbl kosto mesatare totale transport, magazinim.
- K- është vlera \$/bbl e ofruar nga ofruesi mbi çmimin minimal të shitjes të përlllogaritur nga formula (K>0).

### 8. Vendndodhja e naftës brut: Albpetrol sha Patos

Në pikat e lëvrimit CTF Marinëz (Bankers), Stacioni Kuçovë, Stacioni Usojë, 16/1 (ARMO) Ballsh, Stacioni Zharrëz, Stacioni Sheqishte, Stacioni Gorisht.

- Vendi i zhvillimit të ankandit:** Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Sheshi Skënderbej, Tiranë, salla e mbledhjeve kati I-rë.

- Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:** në zyrën e protokollit të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, datë 08/05/2015, ora 11:00

### 11. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit shitës me paraqitjen e një kërkesë me shkrim ose në faqen zyrtare të "Albpetrol" sha www.albpetrol.al dhe në faqen e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë www.energja.gov.al.

### Dokumente me pagesë:

Po  Jo

Nëse Po

Monedha (lekë) Çmimi

### Dokumentet standarde të ankandit përbëhen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për ofertë;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
- Proçesverbali/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatët blerës në kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit.**

Albpetrol sh.a. NUIS J82916500U Selia Rruga Fier-Patos Km. 7 Patos / Zyra në Tiranë Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr.3, Tiranë

T +3553813662

F +35534704415

W www.albpetrol.al

# Lista e rimbursueshme, ja barnat që hiqen për 2015-n

## Çmimi për antibiotikët e barnat në farmaceutikë e spitaleve

DRIÇIM ÇAKA  
TIRANE

Qeveria ndryshon listën e barnave të rimbursueshme për vitin 2015. Në vendimin nr. 367, Këshilli i Ministrave heq nga lista e barnave disa ilaçe që tregtohen në farmaceutikë e spitaleve dhe disa barna që janë në listën e përgjithshme të rimbursimit.

"Lista e barnave që tregtohen në farmaceutikë e spitaleve 2015", në grupin L04, immunosupresivët, bëhen ndryshimet: Bari me kod 214/308, ciclosporin 25mg capsul, hiqet. Bari me kod 215/308, ciclosporin 100mg capsul, hiqet. "Lista e barnave të rimbursuara 2015", bëhen këto ndryshime:



**Vendimi**  
Këshilli i Ministrave heq nga lista e barnave disa ilaçe që tregtohen në farmaceutikë e spitaleve dhe barna që janë në listën e përgjithshme të rimbursimit

### Si ndryshon lista e barnave të rimbursueshme

Kodi Bari	Kodi ATC	Emërtimi kimik	Forma	Emri tregtar	Firma	Çmimi referencë	Çmimi i pacientit	Rimbursimi
214/32	L04AD01	Ciclosporin 25 mg	caps.	Sandimenor Neuror	NOVARTIS	58.10	0.00	58.10
215/92	L04AD01	Ciclosporin 100 mg	caps.	Sandimenor Neuror	NOVARTIS	197.50	0.00	197.50
Barnat e rimbursuara 2015								
Kodi Bari	Kodi ATC	Emërtimi kimik	Forma	Emri Tregtar	Firma	Çmimi Referencë	Çmimi Pacienti	Rimbursimi
C08 CALCIBLOKUESIT								
74/6	C08AH1	Amilofensin 5 mg	tabl.	Amilofensin Alkaloid	ALKALOID	2.50	0.50	2.00
74/73	C08AH1	Amilofensin 5 mg	tabl.	Veron	KRKA	3.20	1.20	2.00
74/204	C08AH1	Amilofensin 5 mg	tabl.	Amilofensin Actavis	ACTAVIS	4.90	2.90	2.00
74/226	C08AH1	Amilofensin 5 mg	tabl.	Amilofensin Genericon	GENERICON PHARMA	7.50	5.50	2.00
74/79	C08AH1	Amilofensin 5 mg	tabl.	Amiprin	LEK	9.00	7.00	2.00
74/237	C08AH1	Amilofensin 5 mg	tabl.	Amilofensin Sandoz	SANDOZ	9.40	7.40	2.00
74/96	C08AH1	Amilofensin 5 mg	tabl.	Norvasc	Pfizer	15.30	13.30	2.00
360/79	J01FA09	Clarithromycine 250 mg	f.c.nabl.	Lekoklar	LEK	30.10	10.50	19.60
360/73	J01FA09	Clarithromycine 250 mg	f.c.nabl.	Freemid	KRKA	30.10	10.50	19.60
360/2	J01FA09	Clarithromycine 250 mg	f.c.nabl.	Clecon 250	AEGIS	44.70	25.10	19.60
361/107	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.nabl.	Raneyon	RAFARM	48.10	16.80	31.30
361/79	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.nabl.	Lekoklar	LEK	53.30	22.00	31.30
361/73	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.nabl.	Freemid	KRKA	53.30	22.00	31.30
361/132	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.nabl.	Efson	BIRNENET PHARMACEUTICALS SA	62.30	31.00	31.30
361/183	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.nabl.	Cabli	NOBIL ILIAC	66.80	35.50	31.30
361/73a	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.nabl.	Freemid Uno	KRKA	70.50	39.00	31.30
361/2	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.nabl.	Clecon 500	AEGIS	74.80	43.50	31.30
361/139	J01FA09	Clarithromycine 300 mg	f.c.nabl.	Claprin	ELEPH	71.50	46.00	31.30
361/216	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.nabl.	Chloride	BILIM ILIAC SANAYH TICARET	80.30	49.00	31.30
361/221	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.nabl.	Clarithon	SO SE PHARM	87.70	50.40	31.30
361/7	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.nabl.	Maxlin	ANFARM HELLAS	102.50	71.20	31.30
361/181	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	tabl.	Klarid LA	ABBOTT	133.60	102.50	31.30
L02 BARNAT NË TERAPIJË ENDOKRINE								
580/267	L02BB03	Bicalutamide 50mg	f.c.nabl.	Bicanide	GENEPHARM SA	119.90	0.00	119.90
580/196	L02BB03	Bicalutamide 50mg	f.c.nabl.	Caotend	ASTRAZENECA	149.90	30.00	119.90
S01 BARNAT OPHTALMIKE								
525/3	S01AA12	Tobramycine 3 mg/ml - 5 ml	pika për sy	Tobrex	ALCON	228.20	91.30	136.90

**Lista**  
Branat e reja që janë shtuar në listën e rimbursimit: Onkologjik, Gastro-hepatologji, Pneuomologji, Reumatologji, Infektiv, në terapinë kardiale, Parkinson, etj

grupin S01, barnat optalmike, bari me kod 525/200, tobramycine 3mg/ml-5ml pika, hiqet", -përcakton vendimi i qeverisë.

### LISTA

Lista e re e barnave të rimbursueshme e vitit 2015 është pasurur me barna të reja, 12 prej të cilave janë principe të reja aktive. "Këto barna përmirësojnë dhe zgjerojnë trajtimin e pacientëve në sër-bime si: Onkologjik, Gastro-

hepatologji, Pneumologji, Reumatologji, Infektiv, në terapinë kardiale, Parkinson, etj. Risia e këtij viti është rimbursimi i materialeve mjekësore", -thotë FSDKSH. Falë ligjit të ri të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit të Shëndësor, tashmë janë hapësirat ligjore për të rimbursuar edhe materiale mjekësore, për të cilat ka patur kërkesa të vazhdueshme në Fond nga popullata në nevojë. Në do

të bëjmë të mundur këtë vit edhe rimbursimin e materialeve mjekësore, siç janë strishat për diabetikët, aç të nevojshme për të mbajtur nën kontroll sëmundshmërinë, e për pasojë, për të patur një mjekim efikas e cilësor për pacientët; qeset njëpërdorimshme për shkarkimin kolostomik, disa pajisje për kardiologjinë invazive, etj. Rimbursimi i materialeve mjekësore bëhet i mundur edhe falë uljes së çmimeve të barnave.

### ➔ Kualifikimi

Ç'përmban portfoli i një arsimtari, vitet e eksperiencës



■ Të gjithë mësuesit mund të japin provimin e kualifikimit për vitin e ardhshëm nëse plotësojnë disa kriteret. Në udhëzimin e publikuar në Fletoren Zyrtare jepen dokumentat që do përmbajë portfoli i një mësuesi. Portfoli personal përmban këto dokumente: Curriculum Vitae (me fotografi), vlerësimin e fundit të performancës që ka marrë kandidati nga drejtuesi i institucionit arsimor dhe fotokopje e notizuar e certifikatave me kredite. Fotokopje e notizuar e dëshmitë të titujve/gradave shkencore (nëse ka), fotokopje e notizuar e dëshmitë të mbrojtjes së gjuhëve të huaja (nëse ka). Portfoli profesional përbëhet nga këto elemente: një plan të një aktiviteti me nxënësit e një klase të caktuar, në kuadër të shkollës si qendër komunitare, një test përmbledhës, sipas profilit përkatës dhe objektivat e arritjeve të nxënësit për një kapitull (në një lëndë dhe klasë të caktuar). Një planifikim të një mësimi model (ditar), duke u bazuar në mësimdhënien me qëndër nxënësin dhe një plan të një projekti kurrikular, së bashku me përshkrimin e realizimit të tij. Procedurave të kualifikimit u nënshtrohen të gjithë mësuesit, të cilët, deri më 31 dhjetor plotësojnë kushtet e mëposhtme për vjetërsinë e punës në arsim: Të paktën 5 vjet punë për kategorinë e kualifikimit "mësues i kualifikuar". Të paktën 10 vjet punë për kategorinë e kualifikimit "mësues specialist" dhe të paktën 5 vjet punë pas marrjes së kategorisë "mësues i kualifikuar". Të paktën 20 vjet punë për kategorinë e kualifikimit "mësues mjeshtër" dhe të paktën 10 vjet punë pas marrjes së kategorisë "mësues specialist".

# Liçenca që do marrin mësuesit për ushtrimin e profesionit

Përcaktohet modeli që do jepet pas provimit të shtetit



Ministria e Arsimit përcakton modelin e liçencës që do jepet për mësuesit e rinj. Në një udhëzim të Ministrës së Arsimit Lindita Nikolla shpjegohet mënyra se si do e marrin mësuesit e rinj liçencën dhe çfarë do të përmbajë ajo. Liçenca për ushtrimin e profesionit rregulluar të mësuesit përmban një numër unik për çdo kandidat, i cili përbëhet nga dhjetë shifra, ku dy shifrat e para tregojnë vitin e dhënies së Provimit të Shtetit, dy shifrat e dyta kodin e profilit dhe gjashtë shifrat e tjera numrin individual të kandidatit. "Agjencia Kombëtare e Protimeve, përgatit liçencën për ushtrimin e



Faksimile e modelit të liçencës që do marrin mësuesit

profesionit të rregulluar të mësuesit sipas proflëve përkatëse, me elemente të veçanta sigurie. Të dhënat e kandidatëve plotësohen nga drejtoritë arsimore rajonale/

zyrat arsimore dhe dërgohen në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe AKP. Liçenca për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit lëshohet nga AKP-ja brenda 45 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të Provimit të Shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit. Liçencat tërhiqen në Agjencinë Kombëtare të Protimeve nga persona e autorizuar nga DAR-et dhe mbahet procesverbal përkatës. Një kopje e liçencës ruhet në arkivin e Agjencisë Kombëtare të Protimeve. Tërheqja e liçencës bëhet pranë DAR-ëve nga kandidatët fitues

ose nga persona të pajisur me prokurën përkatëse", -përcakton udhëzimi i ministres Lindita Nikolla. Me liçencë do të pajisen me liçencë gjithë kandidatët e mëparshëm, fitues në Provimin e Shtetit për ushtrimin profesionit të rregulluar të mësuesit, të cilët janë kandidatët fitues të sezoneve të mëparshme të provimit të shtetit në këtë profesion, që nuk janë pajisur ende me liçencë dhe konkretisht kandidatët pjesëmarrës dhe fitues në sezonet e provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit, dhjetor 2013 dhe korrik 2014.

## Intervista



DRICIM ÇAKA  
TIRANE

**M**ekanizimi që do përdoret për testimin e mësuesve do të bazohet në disa modele ndërkombëtare dhe provimi nuk do të ketë lidhje me njohuritë që ata kanë për lëndët. Kështu u shpreh në një intervistë për "Shqiptarja.com", zëvendësministria e Arsimit Nora Malaj e cila shpjegoi se si do të bëhet provimi në muajin shtator. Gjithashtu zëvendësministria e arsimit përmendi se për Maturën Shtetërore nuk do të ketë asnjë ndryshim përgjatë këtij viti dhe pranimit në Universitet do të bëhen me sistemin meritë-preferencë.

**Ministria e Arsimit pritet të zhvillojë testimin e mësuesve në muajin shtator. Cilat janë arsyet që do të kalojnë në provim arsimtarët?**


Fjala testim është bërë frika më e madhe e qytetarëve në Shqipëri, por realisht nuk kemi të bëjmë me vlerësim por me një mekanizëm matës për probleme të ndryshme që lidhen me fushën e edukimit dhe arsimit. Në muajin mars Ministria e Arsimit dhe stafi i saj, diskutuam dhe pamë që disa nga problemet e shfaqura në sistemin e arsimit që lidhen me menaxhimin e orës së mësimi, menaxhimin e orëve të dhunshme në klasa me situata të ndryshme që kanë familjet shqiptare dhe fëmijët i shfaqin gjatë orëve të mësimi dhe dolëm në përfundim se duhet të parandalojmë problemet e dhunës në shkolla. Por që të parandalojmë këto fenomene, duhet të dimë se cilët janë matësit. Që do të thotë se aktorët kryesor në këtë mes janë nxënësit, mësuesit, prindërit dhe gjithë shkolla duke u lthyer në qëndrë komunikative. Nga analiza që kemi bërë kemi kuptuar që jo të gjithë mësuesit kanë aftësi menaxheriale për të luajtur rolin e ndërmjetësuesit dhe për të mos e çuar konfliktin deri në situatën siç ishte rasti i Shkodrës, u ngrit një grup pune. Ky grup ka për qëllim bërjen e një aktiviteti matës që quhet "instrument matës", për të vlerësuar menaxhimin e situatave në klasë, për të mos patur problematika që na çojnë në situata të vështira. U mendua që të hartohet një test ose një manual dhe përpara se të ndërtojmë këtë manual duhet të dimë se realiteti i kemi mësuesit të aftë, a e di dhe a e ruan të plotë kodin e etikës mësuesi, a dinë të menaxhojnë situatën në klasë? Mbi bazën e kësaj u ngrit grupi që vendosi të zgjedhë disa modele ndërkombëtare që nuk janë teste për të matur dijen por janë situata se si mësuesi do të zgjidhë këtë problem. Qëllimi është që të nxjerrim konkluzionet

## Arsimi




## Mësuesit

"Ky është një instrument për të rregulluar një shkallë tjetër të vlerësimit të mësuesit, që lidhet me sa është i aftë mësuesit për të menaxhuar përveç dijes që ka marrë"



## Masat

"Ministria e Arsimit ka për qëllim që të ndërtojë planin e masave. Kjo do të thotë se do përcaktohen cilat do jenë shkallët e kualifikimit, si duhet të trajnohen mësuesit"



## Maturantët

"Të gjithë maturantët do të pranohen në Universitet me të njëjtin sistem si një vit më parë dhe do të fitojnë ata maturantët që do të arrijnë rezultatet më të larta"

që sa të nevojshme janë trajnimet për mësuesit. Përveç trajnimeve që po bëjmë për kurrikulën e re, përveç trajnimeve që bëjmë për procesin e mësimdhënies të fusim dhe trajnimet të dedikuara, të përcaktuara sipas problematikave të shkollave në mënyrë që nesër mësuesi të bëjë rolin e ndërmjetësit të dhunës në shoqëri. Me këtë intervistë shpresoj që të mbyllem zërat që nuk e duan sistemin e arsimit. Do të bëjmë trajnimin e përcaktuar gjatë gjithë vitit 2016 për të krijuar standardin dhe cilësinë.

## LARGIMET

**"Garanci edhe nga Ministria e Arsimit edhe nga unë si zëvendësministre, ne nuk do të bëjmë "gjueti shtrigash". Historia e largimeve me testime ka mbaruar"**

**Ky instrument matës që do të bazohet në modelin ndërkombëtarë testesh, por a do të maten njohuritë që një mësues ka për lëndën?**

Ky test nuk do të përshtijë njohuritë që mësuesit kanë për lëndën. Instrumenti matës që do të zhvillohet në shtator, nuk lidhet me faktin se sa di mësues për lëndën. Mësuesi sa di dhe si di e bën nëpërmjet kualifikimit të tij. Ky është një instrument për të rregulluar një shkallë tjetër të vlerësimit



## Zëvendësministria

Nora Malaj: Nga analiza që kemi bërë kemi kuptuar që jo të gjithë mësuesit kanë aftësi menaxheriale për të luajtur rolin e ndërmjetësuesit

# "Mësuesit nuk do testohet për dijet, por me teste të huaja"

Zëvendësministria e Arsimit Nora Malaj: S'do të ketë "gjueti shtrigash". Matura edhe këtë vit nuk ndryshon

të jetë më i aftë.

**Shumë maturantë janë konfuz nëse Matura Shtetërore do të ndryshojë këtë vit apo vitin e ardhshëm. A do të ketë ndonjë ndryshim?**

Edhe këtë vit Matura Shtetërore do të jetë hyrëse dhe dalëse, që do të thotë po siç e kemi patur vitet e fundit. Maturantët do të japin po 5 provime, 3 provime që janë detyruese dhe 2 që janë provimet me zgjedhje. Tashmë kandidatët kanë plotësuar formularin A1 dhe A1Z dhe në datën 23 fillon

shimet për ta bërë maturën dalëse dhe jo hyrëse. Të gjithë maturantët do të pranohen në Universitet me të njëjtin sistem si një vit më parë dhe do të fitojnë ata maturantët që do të arrijnë rezultatet më të larta. Të rinjtë e tjerë që nuk dëshirojnë të vazhdojnë Universitetin apo nuk shpallen fitues në njërin nga degët, mund të vazhdojnë kurse kualifikimi, si një nevojë shumë e madhe për tregun e punës, në kuadër të politikave që po ndjek dhe qeveria.

**Lidhur me zgjedhjen e teksteve për vitin e ardhshëm shkollor, a do të grantojë Ministria e Arsimit tekste cilësore për nxënësit, pasi autorvetë që do të konkurojnë për tekstet u është lënë afat deri në 18 qershor?**

Bëhet fjalë vetëm për klasën e parë dhe klasën e gjashtë dhe këto programe kanë qënë të hedhura që në muajin shkurt në uebsajt-in e ministrisë. Shtëpitë botuese kanë mundësinë për të realizuar modelin me të cilin do të konkurojnë. Nuk shikoj ndonjë shkallë vështirësi për shtëpitë botuese. Sigurisht nxënësit nuk do të kenë probleme me pajisjen me libra dhe qëllimi i MAS është të krijojmë një tekst mësimor që të mos nxjerri më analfabet funksional. Do të kemi një tekst unik dhe përzgjedhja do të bëhet sipas ligjit.

## LIBRAT

**"Nxënësit nuk do të kenë probleme me pajisjen me libra dhe qëllimi i MAS është të krijojmë një tekst mësimor që të mos nxjerri më analfabet funksional"**

provimi i parë i gjuhës së huaj. Jemi në fazën që janë marrë të gjitha masat, janë ndërtuar qëndrat, kandidatët janë pajisur me manualin maturantit, janë krijuar këshillat e karrierës dhe po punohet për të krijuar për përzgjedhjen e degëve që do të shkohet në Universitet. Vlerësimi i nxënësve do të bëhet po si një vit më parë, në bazë të kuotave dhe në bazë të meritë-preferencës. Me ndryshimin e ligjit për arsimin të lartë, në 2016 do të shohim ndry-



# Çako: Pezullohen policët e të afërmeve që kultivojnë kanabis

### Do të ndëshkohet çdo efektiv që bëhet palë me subjekt politik

Drejtori i Policisë së Shtetit Haki Çako ka paralajmëruar me largim nga puna të gjithë ata efektivë policie, të afërmit të të cilëve arrestohen për kultivim të bimëve narkotike. “Në rast se do evidentohet dhe procedohet ndonjë i afërm i ndonjë punonjë-

si policie për kultivim të bimëve narkotike, ai punonjësi policie nuk do të jetë më pjesë e Policisë së Shtetit”, është shprehur Çako gjatë takimeve me strukturat e policisë në Qarqet Durrës, Berat e Vlorë. Gjithashtu, gjatë këtyre takimeve, ai ka theksuar rëndësinë e ruajtjes

së imazhit të policies, duke folur për masat për procesin e zgjedhjeve Çako ka theksuar se do të ndëshkohet çdo efektiv policie që do të bëhet palë me ndonjë subjekt politik. “Jemi para procesit zgjedhor. Secili punonjësi policie duhet të tregohet korrekt, i vendosur vetëm në zba-

tim të ligjit. Për cilindo që do çënojë ligjin, rendin e sigurinë, reagimi i policisë do të jetë i menjëhershëm e profesional. Jam i vendosur të ndëshkoj cilindo punonjësi policie që nuk do jetë palë e ligjit, por do bëhet palë e ndonjë subjekti politik”, tha Çako.



Florenc Hoxha

Florenc Hoxha akuzon policinë në krah të ngjarjeve të maskuar. Lidhur me këtë ngjarje, Drejtori i Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV) në bashkinë e Tiranës, në një linjë telefonike nga gazeta Shqiptarja.com është shprehur, se menjëherë ka telefonuar Drejtorin e Policisë së qarkut dhe policia ka shkuar në vendin e ngjarjes vetëm pas tre orësh. “Kam kërkuar ndihmën e policisë. Në fillim kam marrë në telefon Drejtorin e Policisë së Tiranës, por nuk më ka ardhur asnjë lloj shërbimi dhe më pas kam telefonuar 129 dhe komisariatit. Ndërsa, vetëm pas tre orësh ka ardhur një shërbim me tre punonjës policie, si edhe një inspektor krimesh”, të cilët morët edhe disa persona të tjerë në telefon”, tha Hoxha. Gjithashtu, ai shprehet se gjatë ditës së djeshme ka kominuar me prokurorin, si edhe me persona të tjerë të komisariatit për t'i vënë në dispozicion pamjet filmike, por sipas Florenc Hoxhës askush nuk ka shkuar. “Askush nuk ka ardhur deri më tani. Kanë thënë do vijmë dhe ende nuk kanë ardhur të marrin pamjet filmike”, u shpreh kreu i INUV-it për Shqiptarja.com. Ndër të tjera, Hoxha pohoi, se “Në banesë erdhën disa të drejtorisë së qarkut të cilët më thanë se kjo ngjarje është dëmtim prone me zjarr”. Por kjo gjë hidhet poshtë nga Hoxha, i cili sqaron më tej se: “Kjo ngjarje nuk është dëmtim prone me zjarr, sepse dëmtimi i pronës me zjarr është kur brenda në banesë nuk ka persona”. Ndërkohë, vetë Drejtori i Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Vendor e cilëson këtë ngjarje, si vrasje të mbetur në tentativë. “Për mua, kjo ngjarje është “Vrasje e mbetur në tentativë”, por me sa duket duan të mbrojnë autorët që i kanë nisur vetë”, tha Hoxha. Gjithashtu, ai

# Kreu i INUV akuzon policinë për eksplozivin në banesën e tij

### Florenc Hoxha: “Policia nuk ka ardhur të marrë pamjet filmike dhe deklaratën time”

**Hoxha**  
“Në banesë erdhën disa të drejtorisë së qarkut të cilët më thanë se kjo ngjarje është dëmtim prone me zjarr”

rin), më tha se do të vijë të mari pamjet filmike, si dhe do të marri edhe deklaratimin tim dhe të punëtorit që ka qënë roje mëngjesin e së mërkurës. Fillimisht, kur policia erdhi në vendin e ngjarjes pas tre orësh, i kanë marrë rojes një deklaratim të pjesshëm, por mua jo”, u shpreh Hoxha. Kujtojme, se ngjarja ka ndodhur rreth orës 02:30 minuta të së mërkurës, ku sipas Hoxhës mësohet se kanë qënë rojet e shtëpisë së tij të cilët kanë bërë deklaratimin tim dhe të punëtorit që ka qënë roje mëngjesin e së mërkurës. Fillimisht, kur policia erdhi në vendin e ngjarjes pas tre orësh, i kanë marrë rojes një deklaratim të pjesshëm, por mua jo”, u shpreh Hoxha. Kujtojme, se ngjarja ka ndodhur rreth orës 02:30 minuta të së mërkurës, ku sipas Hoxhës mësohet se kanë qënë rojet e shtëpisë së tij të cilët kanë bërë deklaratimin tim dhe të punëtorit që ka qënë roje mëngjesin e së mërkurës.

**Akuza**  
“Askush nuk ka ardhur deri më tani. Kanë thënë do vijmë dhe ende nuk kanë ardhur të marrin pamjet filmike”

fare, do flasim me prokurorin thanë. Sepse edhe ajo do urdhër sekuestro. Kanë ardhur aty dhe nuk kanë bërë shërbimin që duhet të bënin, dhe e kanë klasifikuar këtë ngjarje thjesht për zjarrevënie. Me pak fjalë, edhe në këto momente që ne po flasim (dje), dhe pikërisht pas 48 orësh, policia nuk ka ardhur të marrë as pamjet filmike

### ELBASAN

## Grabitësi i banesës qëllon me çifte policin

— Policia e Elbasanit ka parandaluar një ngjarje të rëndë gjatë ditës së djeshme, ku shtetasi Aleksandër Kuaja me një armë gjuhu ka qëlluar drejt policisë gjatë një tentative grabitjeje të një banese në fshatin Marinëz. Ngjarja ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm, ku Kuaja kishte hyrë për të grabitur banesën e shtetasës me iniciale S.B e cila ka njoftuar menjëherë policinë. Autori ka qëlluar në drejtim të policisë në momentin që ndodhej në oborin e shtëpisë, por fatmirësisht asnjë nga punonjësit nuk ka pësuar dëmtime. Forcat e policisë kanë ndërhyrë duke bërë neutralizimin e tij si dhe sekuestruar armën e gjuhut, së bashku me një brez me 13 copë fishekë të cilën e mbante me lejen e organeve kompetente që prej vitit 1992. Sipas policisë Belsht autori rreth 50 vjeç është ndaluar me akuzën për veprën penale “Vrasja e punonjësve të policisë së shtetit mbetur në tentativë” dhe “Vjedhjes mbetur në tentativë”.

### LAJME shkurt

## Lezhë, kaonsje me armë zjarri, në pranga 2

— Policia e Lezhës ka vënë në pranga dy persona për kanosje me armë zjarri. Të arrestuarit janë Hasan dhe Hajdar Lika 59 dhe 61 vjeç. Arrestimi i tyre u bë, pasi rreth orës 20:00 të së mërkurës, në lagjen nr 5 Sanxhak kanë goditur me sende të forta dhe kanosur me armë, shtetasin Gj.D. Shtetasit H.L, i është gjetur dhe sekuestruar një armë zjarri pistolet M-54. Ndërkaq materialet i kanë kaluar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin për veprat penale “Dëmtime të tjera me dashje”, “Kanosje” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”.



### “Klienti” shitesen në thikë

— Një dyqan i një kompanie të telefonisë fikse dhe shërbimeve të internetit, u sulmua dhe nga një person i cili është futur në dyqan me një thikë në dorë. Autori është futur si klient fillimisht në ambientet e dyqanit dhe aty i ka kërkuar shitësen së dyqanit paratë. Nga verifikimet paraprake, policia konfirmoi se autori i vjedhjes me dhunë ka marrë nga arka e dyqanit një sasi prej 27 mijë lekësh të reja. Por përkundër kësaj, punonjësit e kompanisë thonë se shuma e vjedhur shkon në rreth 400 mijë lekë të reja.


dhe as deklaratën time. Dhe jo vetëm pamjet e mia, por edhe të lokaleve të tjera përreth”, përfundoi Hoxha.

# Durim Bami si Tom Doshi kërkon lirinë në gjykatë

## Sot gjyqi në Gjykatën e Lartë për personin e vetëm në burg

ELTON QYNO  
TIRANE

**D**urim Bami, njeriu që dha dëshminë e tij të rremë të filmuar para deputetit të pavarur të Shkodrës Tom Doshi, duke treguar se ishte Ilir Meta dhe Fatjon Skënderaj që kishin paguar 500 mijë euro për të ekzekutuar Doshin, i është drejtuar Gjykatës së Lartë, duke kërkuar ndryshimin e masës së sigurisë nga "arrest në burg" në një masë më të butë. Kjo lëvizje u krye pak ditë më parë edhe nga deputeti Doshi, i cili nga arrest shtëpie kaloi në masën e detyrimit për paraqitje. Kërkesa është depozituar në sekretarinë e Gjykatës së Lartë dhe se pritet që ditën e sotme të zhvillohet seanca për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Durim Bami nga Fushë-Kruja ka menduar të



Durim Bami

bëhet pjesë e një telenovele, ku ka luajtur rolin e një vrasësi me pagesë, por sapo është shfaqur në publik seria e parë e kësaj telenovele, Bami e ka parë veten në qeli. Mbrojtës i ka kërkuar trupit gjykues se arrestimi i klientit të tij është i paligjshëm, pasi jo vetëm që

nuk është kapur në flagrancë, por është arrestuar për një krim që nuk ekziston dhe që ska ndodhur.

### "S'KAM MARRË POROSI"

Bami në dëshminë e tij ka treguar se nuk ka marrë

porosi nga askush dhe se nuk ka bërë asnjë pazar për vrasje ndaj deputetit të PS në Shkodër Tom Doshi dhe deputetit tjetër të PD në Lezhë, Mëhill Fufi. "...Unë nuk jam vrasës..." -mësohet t'i ketë pohuar grupit të hetimit Bami, duke shtuar se e gjitha

kjo ka ndodhur si pasojë e një shume financiare dhe një "Audi" të blinduar që ia kishtë dhënë Tom Doshi. "Kam pranuar të bëhem protagonist dhe të aktoj në favor të këtij personi. Dëshmia ime para kamaras së Tom Doshit është dhënë në banesat e tij, në Tiranë dhe Durrës, ku kam pranuar të tregoj krimet dhe të përmend emra të ndryshëm, si prokurorë, policë, biznesmenë e politikanë, ashtu siç mi ka kërkuar deputeti Doshi"-ka pohuar para prokurorëve Bami. Më tej ky i fundit ka shtuar se njohjen me Tom Doshit e ka pasur kur një deputet tjetër, që është Mark Frroku, i ka prezantuar në një kafene dhe pas disa takimeve të tjera, Doshi i ka ofruar të luajë rolin e vrasësit me pagesë dhe të stisë ngjarjen e vrasjes imagjinare të Tom Doshit dhe deputetit të PD Mhill Fufi.

### ➔ Pretenca

Vrau me sëpatë, burg përjetë autorit



Prokuroria e Fierit kërkon dënimin me burgim të përjetshëm për shtetasin Emiljano Yzeiraj, i akuzuar për vrasje me paramendim të shtetasit Jetmir Lazaj, ngjarje e ndodhur në datë 13 janar 2014, në fshatin Kalenjë të Mallakastrës. Sipas hetimit dhe gjatë gjykimit, ka rezultuar se viktima është qëlluar me sëpatë, e cila i ka shkakuar vdekjen e menjëhershme dhe shkak i vrasjes ishte fakti që autori kishte një lidhje intime me bashkëshorten e viktimit dhe ai ishte pengesë për vijimin e kësaj lidhjeje.

KREDI ME INTERESA  
TË FAVORSHME

PAKETA SHËRBIMESH  
FALAS

OFERTA EKSLUZIVE  
ME PALETË TË TRETA

## Biznesi i vogël

### Raiffeisen, zgjedhja e duhur për biznesin tuaj

- 8% kredi me hipotekë, 13% kredi pa hipotekë
- -18% shërbime Abcom dhe -3% për çdo furnizim tek Kastrati
- Paketa shërbimesh falas vetëm duke kaluar pagat në Raiffeisen



www.raiffeisen.al

# Vizat me SHBA-në dosja me 16 persona dërgohet në gjykatë

## Prokuroria mbyll hetimet, roli i një shtetasi maqedonas dhe çifti i agentëve që zbuluan grupin

ELTON QYNO  
TIRANE

Për 24 mijë dollarë në dorë, udhëtoje në Shtete e Bashkuara të Amerikës, duke u nisur nga Shqipëria, në Maqedoni dhe më pas në Bullgari. Nga këtu të interesuarit niseshin për në Meksikë, e për të kaluar në mënyrë klandestine kufirin me SHBA-në. Këtë skemë kishte zgjedhur një rrjet i organizuar kriminal, që është shkatërruar një vit më parë nga policia dhe prokuroria dhe që tashmë 16 anëtarë e këtij grupi janë dërguar në gjyq si të pandehur. Hetimet për këtë grup kanë zgjatur plot katër muaj, ndër-kohë që pjesë e grupit ka qenë dhe një agent dhe një agjente policie që kanë kryer veprime stimuluese, për llogari të këtij hetimi. Do agjentët e policisë janë prezantuar para anëtarëve të këtij rrjeti si një çift që kërkonte të udhëtonë në SHBA, dhe pas një sërë veprimesh të tjera hetimore, ata kanë arritur të zëbrdhejnë të gjithë organizimin e grupit të të trafikuar të klandestineve dhe bazat e falsifikimit të dokumentave. Informacionin për veprimtarinë e këtij grupi kriminal, e kanë transferuar në Shqipëri autoritet amerikane, të cilat kanë kërkuar bashkëpunim.

### ROLI I MAQEDONASIT

Prokuroria e Krimeve të Rënda bë me dije se shtetasi maqedonas Nertil Pervizi, mundësonte gjetjen e personave në Bullgari, të cilët ndërmjetsonin udhëtimin e shqiptarëve për në Spanjë në drejtim të destinacionit final Meksikës. Sipas burimeve të orga-nizimit të akuzës, ka rezultuar se shteta-



### Të pandehurit

- Pashko Nilaj 52 vjeç,
- Prel Micaj 60 vjeç,
- Ali Metvelaj 53 vjeç
- Gjergj Martinaj 49 vjeç
- Filip Kertunga 55 vjeç
- Fatmir Bakalli 53 vjeç
- Enver Karaj 50 vjeç
- Fatos Fasko 44 vjeç
- Nertil Pervizi 40 vjeç
- Fatmir Flaga 58 vjeç
- Nikoll Kolaj 49 vjeç
- Zaim Hysenbelliu 53 vjeç
- Durim Koxha 56 vjeç
- Gezim Tafaj 44 vjeç
- Alfred Myrtaj 50 vjeç
- Lek Micaj 28 vjeç në kërkim

sit, të cilët janë dërguar në Amerikë rezultojnë të jenë banorë të qarkut të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe, si dhe me një të përbashkët midis tyre, pasi në Amerikë të gjithë shtetasit që emigruan kundrejt pagesave deri në 20 mijë dollarë kishin një të afërm apo person me lidhje gjaku. Ky element sipas prokurorisë është përdorur nga trafikantët për të humbur gjurmë, me qëllim kalimin e shqiptarëve nga kufiri tokësor Meksikë-Amerikë. Pas hyrjes në Amerikë shqiptarët futeshin në kampe emigrantësh, emë pas të afërmit e tyre shqiptarë me qëndrim të rregullt në Amerikë depozitonin garanci, duke marrë përsipër qëndrimin e tyre në Amerikë. E pikërisht, pas daljes nga kampi njoftoheshin familjarët e mbetur në Shqipëri për të kryer pagesën tek grupi kriminal, 15 prej të cilëve tashmë janë të arrestuar, ndër-kohë vetëm Lek Micaj ndodhet ende në kërkim. Dërgimi në gjyq i këtij grupi kriminal me 16 anëtarësh, është bërë katër ditë pasi prokuroria arresto dhe disa anëtarë të një grupi tjetër kriminal.

### Transferimet



## Nishani dekreton lëvizjet e Lallës në prokurori

— Kryeprokurori Adriatik Lalla ka firmosur ndryshime në prokurorin e Durrësit, Krujës, Tiranës dhe atë të Krimeve të Rënda. Pas propozimeve të këshillit të prokurorëve ish-drejtesit i prokurorisë së Krujës Agron Gjana kalon kryeprokuror në Durrës, ndërsa në vend të tij është komanduar Florjan Binjaku. Henrik Ligori nga krimet e rënda është emëruar zv.prokuror rrethi në Tiranë, prokurori në të cilën drejtues është Petrit Fusha. Ndërsa zv.prokuror tek krimet e rënda është emëruar Besim Hajdamataj i cili më parë ka mbajtur postin e drejtuesit në Durrës. Ndërsa prokurori Genti Osmani nga Elbasani është transferuar në prokurorinë e Krimeve të Rënda, ku i është besuar sektori i sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive që rjedhin nga aktivitetet kriminale. Të gjitha këto lëvizje janë dekretuar pak ditë më parë nga presidenti Nishani. Këto ndryshime vijnë në një periudhë kur kryeprokurori Adriatik Lalla kërkoi ti japë një dimesion të ri punës hetimore, por edhe si pasojë e rotacionit të herë pas hershëm që kryhen në nivelet drejtuese të Prokurorisë Shqiptare. Pak kohë më parë, Lalla largoi nga drejtimi i Krimeve të Rënda dhe prokurorin Eugen Beci, të cilin e komandoi në prokurorinë e Elbasanit. Lëvizjet janë shtrirë dhe në nivelet e mëposhtme të prokurorive.

### LAJME shkurt

## Kurbin, vdes 72-vjeçari nga rryma elektrike

— Një 72-vjeçar nga Kurbin ka humbur jetën pasditen e djeshme, pasi ka rënë në kontakt me rrymën elektrike. Ngjarja ka ndodhur në fshatin Gjorm të Kurbinut, ndërsa mësohet se 72-vjeçari Xhelal Mera, ishte duke punuar tek banesa i tij kur ka rënë në kontakt me energjinë elektrike. Kjo ka rezultuar fatale për 72-vjeçarin, i cili ka gjetur vdekjen e menjëhershme. Menjëherë sapo janë lajmëruar për këtë ngjarje, efektivet e policisë së Kurbinut kanë mbërritur në vendngjarje dhe kanë ngritur një grup hetimor për të kryer veprimet e nevojshme.

## Tiranë, tentoi të korruptonte policin, pranga shoferit

— Një drejtues mjetei është arrestuar dje në Tiranë pasi tentoi të korruptonte një efektiv të policisë rrugore. Mësohet se drejtuesi i mjetit vendosi 1000 lekë në bllokun e gjobave të policit, akt ky që është regjistruar nga kamera që mbante në trup polici. Burime nga policia bëjnë me dije se personi i arrestuar është shtetasi Vehbi Hidri i cili drejtonte automjetin tip "Eolsëagen" me targë AA301JD. Efektivit i policisë rrugore e kishte ndaluar Hidrin për shkak se ky i fundit kishte kryer një parakalim të gabuar.

## Tiranë, kapet 39-vjeçari me 900 doza heroinë

— Një 39-vjeçar është vënë në pranga dje nga policia e Tiranës, pasi u kap me 900 doza heroinë. Nga kontrolli që blutë e kryeqytetit kanë ushtruar në banesën e 39-vjeçarit Fatjon Drenovci në zonën e "Ali Demit" janë gjetur 900 doza heroinë me peshë 300gram dhe një peshore elektronike. Sipas policisë së Tiranës, dyshohet se ky shtetas e shiste drogën në shkollë, në zonat pranë "Ali Demit" dhe "Oxhakut" dhe e shpërdante me motor, poshtë sediljes së të cilit është gjetur sasi heroinë. Ndërkohë po punohet edhe për kapjen e bashkëpunëtorëve të tij.

### Raporti TIRANE

# Gjykata e Lartë dhe 1 në 3 gjykata s'regjistrojnë audiot e proceseve

## Raporti i USAID:Gjykata probleme me transparencën



Një në 3 gjykata në Shqipëri respektojnë procedurën e regjistrimit audio të proceseve gjyqësore që zhvillohen midis palëve,ndërsa dhe pse duhet të ishte shembull për gjykatat e tjera në zbatim të kësaj procedurë regjistrimi i seanceve në sistemin audio nuk respektohet as nga Gjykata e Lartë. "A1Report" ka siguruar një kopje të raportit të USAID për monitorimin e përdorimit të sistemit audio nga gjyqtarët në periudhën Janar-Mars 2015, ku rezultoi se në 24 gjykata të monitoruara vetëm 6 prej tyre regjistrojnë 100 për qind se çfarë ndodh në një seancë. Sipas raportit 3 gjykatat më

problematike të cilat nuk respektojnë këtë procedurë janë gjykata e Elbasanit që ka regjistruar vetëm 7 për qind të proceseve në 3 muaj, ajo e Durrësit

me 35 për qind të proceseve të zhvilluara dhe ajo e Kavajës me 46 për qind. Referuar gjyqtarit Osman Aliu të rrethit gjyqësor Kavajë, ministri i

Drejtnesisë Nasip Naço denoncoi mospërdorimin e sistemit të regjistrimit të proceseve gjyqësore ndërsa gjykata e Kavajës rezultoi një ndër tre gjykatat problematike sipas raportit. Sipas raportit Gjykata e Tiranës, e Krimeve të Rënda, e Apelit në Gjirokastrë, e Apelit në Vlorë, si dhe gjykata e rrethit dhe ajo e Apelit në Korçë janë të vetmet që zbatojnë këtë procedurë, e cila vlen për të kontrolluar qëndrimet e mbajtura në gjykim dhe çka është më e rëndësishmja vendimin që merr gjykata duke shman-gur abuzimet. Por çfarë është

sistemi RDA, regjistrimi audio me zë është i përbërë nga disa mikrofonë,3 të tillë për çdo seancë, sipas rastit në proces penal Gjykatësi, Prokurori, i pandehur ose në proces Civil palët në proces dhe gjyqtari. Ky sistem regjistron në kohë reale çfarë thuhet në sallë dhe e kalon atë automatikisht në një server duke shmangur aksesin për manipulim të provave. Për herë të parë ky sistem është montuar në 2012 në gjykatën e Lezhës, ndërsa aktualisht funksionon në 34 gjykata përfshi dhe gjykatat administrative të krijuara rishtazi.

## » PROBLEMATIKA

**URA** e fshatit Bardhaj në Komunën Rrethina që ndodhet mbi lum Kir është një makth për ata që kalojnë çdo ditë aty. Ajo është e mbushur me gropa të mëdha dhe hekurat e saj janë të pasigurt

Vetëm në pak vite lumi Kir rrezikon të humbasë shumë nga natyrshmëria e tij. Prej vitësh një prej lumenjve më të rëndësishëm të Shqipërisë është lënë pothuajse totalisht në harresë. Në lumin kir shumë faktorë rrezikojnë ta gllabërojnë ashtu siç ka ndodhur në këto 25 vite. Dëmet që ka pësuar ndër gjithë këto vite janë të mëdha dhe absolutisht me një kosto të pallogaritshme për të gjithë ne. Harresa, anashkalimi, neglizhenca apo ndonjëherë edhe abuzimi kanë bërë që lumi Kir të tretet gradualisht pa e kuptuar.

### EROZIONI

Një prej problemeve kryesore që çdo ditë po ja merr frymën lumit Kir është erozioni. Ndër vite dëmet që ka sjellë fenomeni natyror i erozionit janë shumë të mëdha. Mjafton një gjiro e thjeshtë përgjatë bregut të lumit Kir deri në zonat e thella malore për të kuptuar se sa shumë problem ka shkaktuar erozioni në atë lum. Me tonelata material të ndryshme, kryesisht gurë por edhe dheu janë zhvendosur nga zonat malore për të përfunduar deri në fundin e gjatësisë së atij lumi. Këto shndërrime gjatë gjithë këtyre viteve kanë bërë që rrjedha normale e këtij lumi ndonjëherë edhe të ndryshojë. Tashmë rrjedhat e atij lumi janë të shpërndara në disa nëndegë të vogla vetëm si shkak i sasisë së madhe të gurëve apo dheut që janë grumbulluar vetëm si shkak i erozionit. Një zgjidhje absurde apo justifikim që është përdorur është ai i dhënies së lejeve mjedisore dhe të shfrytëzimit për firma të ndryshme për minimizimin e sasisë së materialeve që erozionit i shkaktonte. Madje kjo mënyrë të vepruarit nga institucionet përgjegjëse ndër vite është cilësuar edhe si pastrim. Në fakt këto firma më shumë se e kanë pastruar nga materialet e kanë dëmtuar duke marrë zhavor për ta tregtuar më pas tek firmat e ndërtimit. Në këtë mënyrë asnjëherë nuk ka patur një ndërhyrje serioze për të minimizuar dëmet që erozioni shkaktonte sepse kuptohet që është një fenomen i pashmangshëm.

### MBETURINA PA KRITER

Lumi Kir sidomos në pjesën poshtë urës së Bardhajve është i tejmbushur me një sasi shumë të madhe mbetjesh. Ashtu si erozioni edhe mbeturinat kanë pushtuar lumin Kir thuajse në çdo pjesë të tij. Në gjithë këto vite aksionet për pastrimin e tij kanë qenë shumë të pakta krahasuar me nevojën që ka. Asnjëherë në fakt nuk është menduar seriozisht që ai lum të pastron dhe që të rehabilitohet për ta ruajtur dhe për ta mbrojtur. Mbeturinat çdo ditë ndotin në një sasi të konsiderueshme lumin Kir. Janë edhe vetë qytetarët e pandërgjegjshëm të cilët zgjedhin lumin për të hedhur mbeturinat. Gjithsesi ndëshkimi nga ana e institucioneve ka munguar qoftë për mospastrimin e territorit por edhe për ata qytetarë që hedhin mbetjet në lumin Kir. Përveç mbeturinave ka edhe një sasi të madhe të materialeve inerte duke qenë se është një zonë ku përreth saj ndërtohen objekte ditë pas dite. Jo rrallë herë vetë banorët duke mos patur zgjidhje tjetër ndezin zjarre për të djegur mbeturinat duke rritur



# Shkodër, ndotja e lumit Kir, shkatërrimi e rreziku për banorët

Harresa, anashkalimi, neglizhenca dhe abuzimi kanë bërë që Kiri të tretet gradualisht



### Mbeturinat

Lumi Kir sidomos në pjesën poshtë urës së Bardhajve është i tejmbushur me një sasi shumë të madhe mbeturinash, që kanë pushtuar lumin thuajse në çdo pjesë të tij

### Anti-reklama

E gjithë ajo panoramë zhgënjyese që të ofron lumi Kir menjëherë kapet nga syri i turistëve të huaj, që gjatë sezonit turistik kalojnë në atë segment dhe përballen me pamjen katastrofike



ndjeshëm dëmin mjedisor.

### KOMUNA RRETHINA, KRYEKOMUNARI HARUHA: S'KEMI FONDE

Kryetari i Komunës Rrethina, territor në të cilin bën pjesë lumi Kir deklaroi se nuk ka fonde mjaftueshëm për ta pastruar ashtu siç duhet. Nga ana tjetër kryemunari i Rrethinave tregon se është një projekt në dyert e Qeverisë por që ende nuk është

financuar. "Atëherë kur kemi patur mundësi kemi ndërhyrë për pastrimin e lumit Kir. Për ta pastruar totalisht dhe për të shmangur çdo problem që ka ne si komunë nuk kemi fondet e duhura. Është një investim shumë i madh që vetëm qeveria ose donatorët e huaj mund ta bëjnë. Unë kam kohë që kam dërguar një projekt për lumin Kir në dyert e Qeverisë por deri tani ka qenë e pamundur që të financohet sepse natyrisht ka një kosto jo të vogël.

Jemi në pritje dhe shpresojmë që ai projekt të financohet sepse lumi Kir është i rëndësishëm për ne"-deklaroi kryekomunari Harusha.

### IMAZHI ASPAK I MIRË NË SYTË E TURISTËVE

E gjithë ajo panoramë zhgënjyese që të ofron lumi Kir menjëherë kapet nga syri i turistëve të huaj. Me mijëra turistë të huaj gjatë sezonit turistik kalojnë në atë segment dhe

përballen me shkatërrimin, mbeturinat dhe katastrofën e lumit Kir si shkak i harresës dhe dëmeve që i janë shkaktuar gjatë këtyre 25 viteve. E nëse një turist zgjedh të ndalet imazhi që përfton nuk është aspak i mirë. E nëse shpreh edhe ndonjë foto për ta arkivuar atëherë është një minus i madh sepse jo rrallë herë foto të tilla të turistëve që janë shkrepur në të tilla zona problematike por që kanë resurse për sezonin turistik janë shfaqur në portale të ndryshme botërore duke ndikuar drejtpërdrejt në mënyrë negative.

### URA E BARDHAJVE NË KUSHTË TË MJERUESHME!

Ura e fshatit Bardhaj në Komunën Rrethina që ndodhet mbi lumin Kir është një makth për ata që kalojnë çdo ditë aty. Prej shumë vitësh asnjëherë në atë urë nuk është investuar seriozisht për ta rikonstruktuar ashtu siç duhet. Ura është tejet e amortizuar teksa është e mbushur me gropa të mëdha që ia vështirësojnë shumë punën banorëve të shumtë që përshkohen ashtu. Hekurat e urës sidomos për fëmijët e vegjël janë totalisht të pasigurt. Në shumë pjesë ka çarje të tubave dhe po ashtu kudo mbizotëron ndryshku që është krijuar ndër vite. Ndonëse jo në një gjatësi të madhe ura e Bardhajve nuk ka asnjë lloj sigurie sidomos për mjetet motorike që kalojnë aty. Mjaftonë pak minuta për të qëndruar mbi urë dhe frikësohesh sepse sa herë kalojnë mjetet, sidomos furgonët, ura dridhet jo pak sikur të jetë ndonjë trëmthet i vogël vetëm si shkak i pasigurisë dhe amortizimit total të saj. Po ashtu poshtë saj në shumë pjesë infrastruktura e asaj ure tregon qartë se nuk ka aspak siguri. Është e dëmtuar në shumë pjesë të saj dhe fare qartë dallohet se kanë munguar investimet. Shpesh herë banorët kanë bërë apel që të rikonstruktohet ajo urë por ndërhyrjet që janë bërë kanë qenë momentale dhe situata ka agravuar sërish duke rikthyer rreziqet.

### NDOTJA E PUSEVE TË UJIT SI SHKAK I MBETURINAVE!

Në shumë zona përreth ku kalon lumi Kir dhe që shërben edhe si burim për ujën e pijshëm për qindra banorë ndotja është e madhe dhe po ashtu e rrezikshme. Si shkak i përzjerjes me një sasi të madhe mbeturinash e mbetjesh nga më të ndryshmet, uji nuk është i pastër. Edhe pse me sasi të konsiderueshme të ndotjes, banorët në pamundësi të sigurimit të rrjetit të ujësjellësit nga institucionet detyrohen që përmes shpimeve të marrin ujë nga pusët nëntokësore. Ky ujë buron pikërisht nga lumi Kir dhe shkon ndër këto puse ashtu i ndotur dhe konsumohet nga qindra banorë sepse nuk kanë një zgjidhje tjetër. Jo rrallë herë ka patur persona të infektuar nga ndotja e ujit por çdo gjë ka rënë në vesh të shurdhër dhe gjendja ka vijuar të jetë e njëjtë.

Nëse situata nuk ndryshon dhe vazhdon ndotja e lumit Kir, djegia e mbeturinave në lum apo lëmia në harresë e urës së Bardhajve dhe zonave tjera aty pranë atëherë banorët janë të kërcënuar nga një sërë problematikash që duhet të marrin zgjidhje sa më shpejt.

# » REPORTAZH

**NIKAJ-MERTURI** është një vend shumë interesant për të zhvilluar turizmin, alpinizmin dhe sporte të tjera malore


**GJON NEÇAJ**  
TIRANE

**N**ikaj-Mérturi bën pjesë në rajonin verilindor dhe zë pjesën perëndimore të rrethit të Tropojës, në anën veriperëndimore të luginës së Drinit, duke u kufizuar në lindje përmes Majës së Korës dhe Qafës së Kolçit me komunën e Bujanit dhe të Fierzës dhe në perëndim përmes Qafës së Ndërmanjës dhe Qafës së Agrit me komunat e Shalës, Shoshit dhe Temalit, të rrethit të Shkodrës. Qendra e komunës është në fshatin Lekbibaj, e cila është 27 km nga qyteti i Bajram Currit dhe 13 km nga Fierza. Popullsia e Nikaj Mërturit është rreth 2700 banorë, të vendosur në rreth 200 km<sup>2</sup>, kryesisht në vendbanime të rralla e rurale. Në fillimvitet '90 kjo trevë kishte arritur në 9000 banorë të shpërndarë në 12 fshatra, por në regjistrimin e fundit del me më pak se 2700 banorë ose afro 60 përqind e banorëve kanë migruar brenda vendit. Fshatrat e Nikaj Mërturit janë të shpërndarë në të gjithë zonën, afër liqenit, lumenjve dhe disa edhe afër bjeshkëve, si Bëtoshja, Brisa, Salca, Peraj, Vrana, Curraj Epër, Qereshi dhe Mulaj. Ato janë vendosur në çdo vend ku ka qenë e mundur të ndërtohet një shtëpi dhe të ketë edhe një copë tokë, si në maja kodrash, livadhe, por disa kulla janë ndërtuar edhe në shkëmbinj, kthyer me kurriz nga humnera për arsye mbrojtjeje nga sulmet e pushtuesve dhe gjakmarja.



## Perla e pashfrytëzuar e Alpeve Shqiptare

Një përshkrim i krahinës së Tropojës që ka shumë për të ofruar me bukurinë e saj



### SI MUND TË ARRIJMË

Në Nikaj-Mérturi shkohet përmes liqenit të Komanit me anije dhe ndalohej në stacionin që quhet Kodër Markaj, rreth 10 km pa shkuar në Fierzë. Përmes rrugës nacionale që kalon nga Qafa e Malit, duke u kthyer majtas në Fierzë dhe vazhduar sipas rrjedhës së Drinit.

Rruga nacionale që vjen nga Fierza, te Ura e Mërturit, ndahet në dy degëzime, njëra që vazhdon për në Lekbibaj, ku është edhe qendra e komunës, pastaj vazhdon për në fshatin Mserr ku ndahet për në Salcë dhe në Lugun e Ndërmanjës. Tjetra vazhdon bregut të lumit për në Shëngjeri, kalon afër Bëtoshës dhe vazhdon nëpër rrugën shekullore të Pultit të Vjetër, për në Qafën e Kolçit e lidhet me Tropojën (Malësinë e Gjakovës).

### ÇFARË OFRON

E ndodhur midis bjeshkëve dhe majave të larta, është një zonë shumë e veçantë ku shfaqen dhe ndërthuren kontraste të papara, ku përballen e bukura dhe e vështira, madhështia dhe ashpërsia, pamjet mahnitëse me infrastrukturën e dobët, mundësitë e shumta për zhvillim me një prapambetje relative, ashpërsia natyrore e terrenit me butësinë hyjnore të peisazhit, e kaluara e lavdishme dhe e sotmja që po ndryshon. Zona përshkohet tej tej nga dy lumenj: lumi i Currajve dhe i Vranës e që burojnë nga bjeshkët e larta me ujë të pijshëm që nga burimi e deri ku bashkohen për t'u derdhur në lumin Drin. Nuk ka fshat që nuk i ka nga dy, tre e më shumë kroje me ujë të pijshëm, që për nga pastërtia pa dyshim që do të

### Baroni Nopça

Franc Nopça, që vizitoi Nikaj Mërturin në fillim të 1900 si deputet i parlamentit austriak, kishte propozuar që Nikaj Mërturin ta shpallnin monument kulture nën mbrojtje ndërkombëtare, për bukuritë e rralla

konkurronin çdo ujë në botë, pasi secili prej tyre zanafillen e ka nga bjeshkët e larta, ku bora e re pushon mbi borën e vjetër. Pjesa më e madhe e zonës është me pyje e kullota, pasi toka bujqësore e përdorur për mbjellje është e vogël, por është interesant fakti që shumica e saj ndodhet nën vadë.

Peisazhi natyror është i paimaginueshëm, me monumente natyrore të shumta e të rralla. Pyjet me gështenja krijojnë kurora të mrekullueshme rreth e rreth fshatrave, sidomos në fshatin e Lekbibajve apo në Markaj, Tetaj etj, frutet e të cilave konkurrojnë në çdo treg. Arra dhe lajthija përbëjnë një tjetër pasuri që natyra ia ka falur Nikaj-Mërturit, sidomos lajthia, e cila vende-vende formon edhe pyje të tëra, si p.sh në fshatin Qeresh, ku e gjithë kurora e këtij fshati deri në Qafën e Qereshit dhe përrreth saj është e formuar nga pyje lajthish. Trofta e lumenjve të Nikaj-Mërturit, mjalit, si dhe prodhimet blegtorale, të gjitha organike janë shumë cilësore.

### TURIZMI

Nikaj-Mérturi është një vend shumë interesant për të zhvilluar turizmin, alpinizmin dhe sporte të tjera malore. Rikonstruktimi i rrugës ekzistuese nga Fierza në qendër të komunës është në vazhdim me një fond prej mbi 600 milionë lekësh, ku janë janë kryer mbi 60 përqind të punimeve, si: vepra arti, zgjerime etj. do ta bëjë më të vizituar këtë trevë, ku ndërtimi i rrugës auto-

mobilitike për në lugun e Ndërmanjës e në Vrane, si dhe ndërtimi i rreth dhjetë kilometra rrugë për në Curraj Epër, do ta bënte kthimin e Nikaj Mërturit në një perlat më të bukura të turizmit malor në Shqipëri e më gjerë. Do të përmendim vetëm disa emra vendesh, si: perlën e Alpeve Shqiptare, Currajn e Epër, Qereshin, Kuçin, Boshin, Alshinën, Kakinë, Zallin e Ortegut, Shpellën e Kakverrit, T'hermen, Fangjet, Rrukun e Nikajve, Listrami i Bëtoshës, Vorri i Fratit, Shtegu i Dashit, Piku i Currajve, Çuku i Llapushtrës mbi Rajë, Shterzajca e Brisës, Logu i Gurrës e bjeshkët e Salcës, Okoli i Palçit etj etj.

Gjatë verës shijohet tamli me borë, boronicat, mjedrrat, drethëzat, dardhat gjokme, hardallitë, flina, leqentku i mestitur, mazë e zier, fërliugu (traditë e hershme e zones), mishi i tharë në tra mbi oxhak (postermë), bacrugat e gështenjave etj. Përveç bukurive natyrore dhe ushqimeve karakteristike të zonës, turistët do të ulen këmbëkryq me trashëgiminë kulturore të krahinës së Nikaj Mërturit si në asnjë vend tjetër. Do të ishte i padiskutueshëm interesi i turistëve të huaj që krahas bukurive përrallore të kësaj zone, të njiheshin me folklorin e pasur, këngët dhe veglat muzikore, veshjet e larmishme, dasmat dhe ritet e zakonet mortore, të cilat dëshmojnë për një zonë jashtëzakonisht të pasur me etnokulturë të veçantë dhe të bukur. Jo rastësisht, Franc Nopça, i cili kishte vizituar Nikaj Mërturin në vitet 1900 të shekullit të kaluar, si deputet i parlamentit austriak, kishte propozuar që Nikaj Mërturin ta shpallnin monument kulture nën mbrojtje ndërkombëtare, për bukuritë

e rralla dhe për njerëzit e mrekullueshëm. Diçka ka filluar të lëvizin, thonë drejtuesit e komunës Lekbibaj. Ka pasur disa ekspedita turistike, duke filluar që nga viti 1993, e deri te më e fundit verën që kaloi, nga Italia, Sllovenia etj, të interesuar për eksplorimin e shpellave. Kanë arritur të hyjnë disa kilometra në shpellën Bira e Zezë në fshatin Qeresh dhe janë mahnitur me madhështinë dhe bukurinë e asaj shpelle. Shpella vazhdon edhe më tej dhe, sipas tyre, shpërndahet në katër drejtime të ndryshme. "Sot për sot, si pasojë e infrastrukturës së vështirë që ka zona e Nikaj-Mërturit, - thotë kryetari i komunës, Gëzim Meshaj, - sektori i turizmit nuk është zhvilluar. Kjo ka bërë që kjo zonë të jetë e virgjër, pra gjithçka natyrale. Duke pasur parasysh potencialet e shumta turistike që ka zona, turizmi malor e në veçanti ai dimëror, do të jetë në të ardhmen një nga mundësitë më të mira për zhvillimin e kësaj krahine. Me punën e përkushtuar të komunës, në tetor të vitit 2014, krahina e Nikaj Mërturit u shpall Park Natyror Rajonal."

Në bashkëpunim me komunën, me shoqatat dhe qendrat mjedisore do të bëjmë të gjitha përpjekjet e mundshme në mënyrë që zhvillimi i turizmit në këtë zonë të bëhet në mënyrë të tillë duke ruajtur origjinalitetin e shtëpijeve alpine, kullave, qoftë rikonstruktimin e atyre të vjetra apo ndërtimin e atyre të reja, në shërbim të turizmit, dhe jo ndërtimin e hoteleve, pavarësisht nga fuqia ekonomike e investitorëve, pra larg betonimit të kësaj treve, deklarojnë drejtuesit e komunës".


### ALPINIZMI

Relievi ofron kushte shumë të mira për zhvillimin e alpinizmit amator dhe sidomos atij profesionist, pasi e gjithë zona rrethohet nga maja mbi 2000 metra dhe me rrëpira fantastike. Vendet më të përshtatshme për alpinizëm janë: vargmali Ershel - Ndërmanjë - Kaki, Qafa e Kolçit, Shkëmbi i Rajës dhe përrreth Korës së Mërturit etj.

Është me shumë rëndësi të përcaktohen edhe lëvizjet e alpinistëve në këto vende dhe është duke u përgatitur guida e posaçme së bashku me hartën e zonës dhe do të shpërndahet nëpër agjencitë turistike e sidomos në qendër të komunës, në mënyrë që t'u jepen turistëve në dorë përpara se ata të nisen për në faqet e maleve, thotë Ndoc Mulaj, president i Qendrës Mjedisore "Alpe" dhe një ndër intelektualët e Nikaj Mërturit.

### CURRAJ I EPËR

Një luginë në mes malesh rrethuar me maja të larta, në formën e një amfiteatrit të qëndisur nga natyra, në mes të fshatit është një fushë e madhe e rrethuar me shpatë në mes të së cilës kalon lumi me ujëbore. Në mes të fushës, pra, në qendër të fshatit ndodhet një kodrinë mbi të cilën është e ndërtuar kisha e Currajve, 150-vjeçare. Në të dyja shpatet anësore janë të ndërtuara kulla guri me nga dy e tre kate. Një objekt shumë i rëndësishëm në Curraj Epër ka qenë "kulla e ngujimit" ose siç u quajt më vonë "kulla e thepit", sepse ishte e ndërtuar mbi një thep përballë urës, në mes të fshatit. Por tashmë kjo kullë simbol i historisë dhe heroizmit të kësaj zone, nuk ekziston. Ajo para dy vitesh u shemb totalisht. Imzahi i saj është vetëm nëpër fotot e Ndocit, apasionues i fotografisë. Nikaj Mërturi është perla e pa shfrytëzuar e Alpeve shqiptare.



### Dy lumenjtë

Zona përshkohet tej tej nga dy lumenj: lumi i Currajve dhe i Vranës e që burojnë nga bjeshkët e larta me ujë të pijshëm që nga burimi e deri ku bashkohen për t'u derdhur në lumin Drin

# Shqipëria në gjurmën e një "TAP"-i të dytë

NGA **GENC KONDI**

vijon nga faqja 1

...ka shanse që në territorin e vendit tonë të kalojë degëzimi i një linje të dytë ndërkombëtare. Këtë e njofton gazeta greke "To Vima". Sipas saj, i ngarkuari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Energjinë Amos Hochstein do të prezantojë brenda dy javëve të para të muajit maj një propozim amerikan për një projekt alternativ të një gazsjellësi të ri, me një shtrirje tubacionesh, që të përfshijë Shqipërinë dhe Bosnje-Hercegovinën.

Kjo vjen ndërkohë që grupe negociatore nga Rusia, Turqia, Serbia, Greqia, Maqedonia, Hungaria dhe - me shumë gjasa - edhe nga Austria do të takohen gjatë këtij muaji në Athinë

për të diskutuar mbi projektin rus për gazsjellësin që do të kalojë nëpër këto vende. Sipas ministrit të Jashtëm grek, Nikos Kotzias, investimi, që do të shtrihet në territorin grek, kap shifrën e 2.5 miliardë dollarëve dhe financimi mund të sigurohet nga kompani dhe banka perëndimore.

Gazeta "To Vima" shkruan se ajo çka Greqia do të marrë si paradhënie nga Rusia në rast të ndërtimit të këtij gazsjellësi janë rreth 5 miliardë dollarë.

Greqia vijon të luajë me dy porta. Këto deklarata shefi i diplomacisë së Athinës i bëri pas një vizite 5-ditore në Uashington. Normalisht, SHBA po përpiqen të ruajnë një Greqi brenda strukturave evropiane dhe atlantiko-veriore. Athina, nga ana tjetër, nuk mungon të luajë kartën e përkatësisë



ortodokse, sado të largët, me Rusinë e Putinin, çka nuk tremb seriozisht Brukselin apo Uashingtonin, por, gjithsesi, ve në lëvizje perëndimorët për arsye gjeopolitike.

Shqipëria ka shansin tjetër të madh, pas TAP-it, të jetë sërish në qendër të projekteve madhore të hidrokarbureve. Jo për meritë të saj, por të pozicionit gjeostrategjik. Një

shans i tillë mund të minohet vetëm nga një situatë konfliktuale, që po shfaqëron gjithnjë e më shumë fushatën elektorale, pa nisur ende zyrtarisht. Le të shpresojmë që ndërkombëtarët të vijojnë të gjykojnë se sherrt tona politike dhe ndonjë karrike e hedhur në mitingje nuk janë të tilla gjëma, që të pengojnë investime serioze.

Kemi 25 vjet që shpresojmë...



BLOG PERIFERI

## Pa dashuri...

NGA **ALBA MALLEZI**

vijon nga faqja 1

Fytyra të trishtuara në promovime për veprimtari përgjithësisht të mira, që duhen parë, duhen ndjekur, njerëzit duhen nxitur të shohin dhe të vizitohen, të prekin artin dhe të depërtohen prej tij. Por diçka mungon.

Duket sikur kush i bën, organizon, nuk e ka mendjen aty, nuk e ka dashurinë. Prezantohen, por përjetimi nuk është këtu-tani, mendja ndërkohë ka nisur e fluturon gjetkë. Aktivitetet janë pa shpirt.

Nëse do të duhej të bëja një vërejtje për punët për artin që po bëhen në Tiranë, mund të them këtë: po bëhen pa dashuri, pa përfshirje, si në klandestinitet, pa e marrë vesh njeri, apo duke u marrë vesh në momentin e fundit. Por Arti nuk është kështu... Arti është festë, është debat, është pasion, është gjithëpërfshirës. Arti nuk është... "po organizoj këtë, por mos e marrë vesh njeri, ose ta marrin vesh e të vijnë miqtë e maksimumi miqtë e miqve".

Dhe unë e kam një teori timen se përse kjo po ndodh: Sepse po mbahen gazetarët

larg. Mendoj se për çështje të Artit sot, gazetarët, ata që gërrmojnë, shikojnë, polemizojnë, shijojnë dhe ua përcjellin publikun aktivitetin po mbahen larg, ose afrohen ata klientelistë (që nuk do të thotë se janë të majtë apo të djathtë, me parti apo pa parti,

thjeshtë gazetarët miq, ata të kafes, llafes etj).

Më bëri përshtypje ajo që më tha Admirina Peçi, një nga gazetarët më të mira, më të vjetra të kulturës në median shqiptare: Ka ca kohë që unë nuk po marr vesh fare se çfarë po ndodh në Kulturë.

Institucionet sot, politikanët, administratorët, mendojnë se po t'i bëjnë vetë ca foto vetes e të publikohen në FB apo rrjete sociale, e bënë lajmësin pranë opinionit publik, kështu ata kanë ndërprerë, shmangin me bezdi gazetarët. Një komunikatë shtypi me disa

foto e një tekst, siç ishte ai i shpërndarë për përfaqësimin tonë në Bienalen e Venecias apo të tjera aktivitete, nuk do ta ketë asnjëherë shkëlqimin, impaktin, jetën, që jep një shkrim, impresion, shkruar edhe nga gazetari më i keq: Ai vien sepse është një perceptim i drejtëpërdrejtë dhe i vërtetë, pavarësisht këndvështrimit.

Kujtoj si gazetarë kulture, "skandalet" e zbuluara në Bienalen e Tiranës të 2001, kur Arti bëhej me pasion në Tiranë dhe po me aq pasion aktivitetet e Artit. Kur zbulova atëherë se fotografi i njohur italian Oliviero Toscani nuk kishte marrë pjesë, por disa artistë të rinj pjesëmarrës të Bienales ishin infiltruar gojja si nën kurimin e tij. Ai lajm edhe sot njihet si "komploti i Tiranës" në art, dhe pas atij lajmi, nuk mbeti shqiptar pa vizituar, parë, gërmuar Bienalen e Tiranës së vitit 2001. Tirana u kthye në qendër të vëmendjes dhe gazetarët janë lajmësit më të mirë. Gazetarët afrojnë ose largojnë opinionin publik me institucionet që kanë gjithnjë tendencën të vetëizolohen. Gazetarët janë të domosdoshëm për shpirtin e një lajmi dhe një aktiviteti.



# DOKUMENTET SEKRETE

Vrasja e ndodhur në Kavajë më 10 korrik 1990, u gjykua në 20 shtator të atij viti, pra 2 muaj e 10 ditë më vonë. Ndërsa hetimet e para dhe dëshmitarët nxirrnin fajtorë sambistët për vrasjen e Josif Budos, dokumentet e hetuesisë së përgjithshme e zbardhin ndryshe ngjarjen dy muaj më vonë. Më poshtë sjellim dy dokumente ku jepen hollësi nga hetimimet dhe gjykimi i kësaj ngjarje, dhe ku fajësohet si autor i vrasjes në Kavajë, polici i këtij qyteti Luan Allajbeu ndërsa shfaqësohen dy sambistët që dinin fajtorë nga hetimet e para të kryera direkt pas ngjarjes.

## DOKUMENTI 1 REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË HETUESIA E PËRGJITHSHME

Sekret  
Nr. 959 Prot.

Ekzemplar Nr. 4

Tiranë, më 22.09.1990

Lënda: Për gjykimin dhe dënimin e ish-policit Luan Allajbeu

për vrasjen e kryer në Kavajë  
Në datën 20.09.1990 u zhvillua gjyqi për çështjen penale në ngarkim të të pandehurve Luan Allajbeu akuzuar për krimin e vrasjes me dashje të parashikuar nga neni 84/a i Kodit Penal, Edmond Cullhaj dhe Bukurosh Koleci akuzuar për krimin e shpërdorimit të detyrës të parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal. Gjyqi u zhvillua në Durrës me trup gjykues nga kolegji ushtarak i Gjykatës së Lartë dhe duke asistuar një prokuror ushtarak nga Prokuroria e Përgjithshme.

Gjyqi përfundoi brenda ditës. Në bazë të vendimit të formës së prerë, Luan Allajbeu u deklarua fajtor për krimin e vrasjes të parashikuar nga neni 83 i Kodit Penal dhe u dënua me 20 vjet heqje lirie. Dy të pandehurit e tjerë u deklaruan fajtorë për krimin e shpërdorimit të detyrës që ishin akuzuar dhe u dënuan me kohën e paraburgimit. Gjatë gjyqimit, gjykata ndryshoi cilësimin ligjor të veprës penale të kryer nga Luan Allajbeu nga krimi i vrasjes së cilësuar të parashikuar nga neni 84/a në krimin e vrasjes së thjeshtë të parashikuar nga neni 83 i Kodit Penal.

Në përgjithësi, gjatë gjyqimit të tre të pandehurit qëndruan në të njëjtat shpjegime të dhëna gjatë zhvillimit të hetimeve. Një pjesë e dëshmitarëve nga Kavaja u orvatën padrejtësisht që të fajësonin për vrasje policët sambistë. Kjo tendencë e tyre ishte konstatuar edhe gjatë hetimit.

Gjatë gjyqimit, në sallë, u ruajt normalisht qetësia dhe nuk u krijuan vështirësi për trupin gjykues. Në përfundim të gjyqimit, oficeri i policisë Rexhep Myzeqari si dhe policët Besnik Goxhaj, Nazmi Halili, të pakënaqur me vendimin e gjykatës, kanë kundërshtuar trupin gjykues në mënyrë krejtësisht të pahijshme për punonjës të organeve të punëve të brendshme. Sjella e tyre u bë problem menjëherë dhe ndaj tyre organet e emërtesës sonë morën brenda ditës vendimin për lirim nga organet e punëve të brendshme.

KRYETARI I HETUESISË SË PËRGJITHSHME QEMAL LAME  
(firma)

## DOKUMENTI 2 REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË HETUESIA E PËRGJITHSHME

Sekret  
Nr. 1077 Prot.


Ekzemplar Nr. 27

Tiranë, më 25.10.1990

Lënda: Për zbulimin e autorit të një vrasjeje në Kavajë

### HETUESIVE TË RRETHEVE

Në datën 10.07.1990 Dega e Punëve të Brendshme e rrethit të Durrësit në bashkëpunim me repartin 326 të policisë në Tiranë kishin marrë detyrë të veçantë për mbrojtjen e rendit në qytetin e Kavajës nga elementët vagabondë e huliganët që kishin bërë grumbullimin e paligjshëm dhe



# Vrasja në Kavajë, si u devijua faji nga sambistët tek polici


Gjyqi për vrasjen në Kavajë: Fajtor polici Allajbeu jo sambistët. Dëshmitarët nga Kavaja u orvatën padrejtësisht të fajësonin sambistët...Kjo tendencë u pikas edhe gjatë hetimeve.

kishin thyer të gjitha xhamat e lokaleve të tregtisë natën e datës 04.07.1990.

Në mbrëmjen e datës 10.07.1990, rreth orës 21:00, gjatë kryerjes së veprimeve nga ana e policisë u kryen disa veprime dhune nga disa policë që krijuan indinjatë në popull. Si rezultat i kësaj ka ndodhur përleshje deri në përdorimin e armës, midis forcave të policisë dhe disa qytetarëve ku gjeti vdekjen nga goditja me armë Josif Budo, 21 vjeç dhe u plagos edhe vëllai i tij.

Në datën 11.07.1990 në qytetin e Kavajës u organizua grumbullimi i paligjshëm në varrimin e Josif Budos.

Për të zbuluar autorët e vrasjes së Josif Budos, sqarimin e të gjitha rrethanave të tjera që lidheshin me ngjarjet e ndodhura në Kavajë, hetuesia në bashkëpunim me organet e punëve të brendshme, prokurorinë e gjykatën, kreu veprimet e mundshme hetimore. Pas ngjarjes së datës 10.07.1990 u shkua menjëherë në vend, por nuk mund të kryeshin veprime hetimore për shkak të situatës së tensionuar. Vendi i ngjarjes ishte bllokuar nga rrugaçët e huliganët dhe familjarët kishin marrë nga spitali të vrarin pa lejuar të kryeshin veprimet e këqyrjes dhe autopsia. Të nesërmen në mëngjes grupi i hetuesve vajti përsëri. Nga



...LORE SOCIALISTE E SHQIPERISE  
...IA E PËRGJITHSHME  
...1077 Prot.

Sekret  
Ekzemplar Nr. 27  
Tiranë, më 25.10.1990

...e autorit të një vrasje në Kavajë

...SIVE TË RRETHEVE

...7.1990 dega e punëve të brëndshme e rrethit  
...m me repartin 326 të policisë në Tiranë  
...antë për mbrojtjen e rendit në qytetin  
...abondë e huliganë që kishin bërë grumbullime  
...shin thyer gjithë xhamat e lokaleve

...10.7.1990, rreth orës 21.00, është  
...njetë në popull. Si rezultat i kë-  
...rdorimit të armëve, midis forcave  
...jeti vdekjen nga goditja me  
...edhe vëllai i tij.

...osif Budos.

...jes së Josif Budos, sqari-  
...eshin me ngjarjet e ndo-  
...rganet e punëve të brën-  
...ndshme hetimore. Pse

nëpër disa sirtarë dhe që përfundimisht kishte mbetur pranë një dengu me fletore.

Menjëherë u krye eksperimentimi i predhës. Konkluzioni i aktit të ekspertimit balistik ishte se ajo ishte qitur nga pistoletat që i takonte punëtorit të policisë së Kavajës, Luan Allajbeu. Megjithëse akti i ekspertimit ishte shumë bindës, mbasi dhe tabela fotografike që i ishte bashkëngjitur pasqyrore më së miri konkluzionin kategorik të aktit, për objektivitë të gjykua që të ribëhej ekspertimi i predhës nga një grup tjetër ekspertësh kriminalistë. Konkluzioni i aktit të dytë ishte i njëjtë me konkluzionin e aktit të mëparshëm.

Në këto kushte vërtetohet se punëtori i policisë Luan Allajbeu së paku kishte shtënë në mënyrë horizontale. Mbi bazën e vrimës së hyrjes së predhës në kinkaleri dhe asaj të shkaktoar në sirtar u bë përcaktimi i drejtimin, i pozicionit dhe i distancës së qitjes, përcaktim që u shoqërua dhe me një skicë të qartë dhe tepër orientuese për zhvillimin e ngjarjes.

Mbi bazën e këtyre provave u vendos arrestimi i Luan Allajbeut në datën 30.07.1990. Ndërkohë që fillimi i pyetja e të pandehurit u punua për të siguruar dhe prova të tjera, fajësinë ose pafajësinë e tij. Pyetja e disa dëshmitarëve të rinj, si dhe ripyetja e disa dëshmitarëve bëri të mundur që të mblidheshin të dhëna se një polic me uniformë kishte shtënë mbi viktimën duke qëlluar tre herë rresht me pistoletë nga vendi ku ishte përcaktuar me eksperimentimin hetimor. Një dëshmitar shpjegoi se polici fillimisht e goditi me tullë viktimën, i cili u rrëzua përtokë dhe se në momentin kur ai po çohet e qëlloi tre herë me pistoletë e me të shtënë e fundit realizoi vrasjen e tij.

Të gjitha këto prova shërbyen për të përcaktuar një taktikë të drejtë pyetje për të pandehurin. Fillimisht ai nuk pranonte që të kishte shtënë me pistoletë në vendin e ngjarjes. Por përballë provave të pakundërshtueshme, e pranoi këtë fakt. Fillimisht pranoi se kishte shtënë me pistoletë rreth 40 metra larg vendit të ngjarjes. Më pas pranoi se kishte shtënë afër vendit të ngjarjes por nuk pranoi që kishte shtënë drejt viktimës, por në ajër, shpjegim ky që binte në kundërshtim me drejtimin e qitjes dhe me faktin e gjetjes së predhës brenda në kinkaleri.

I rëndësishëm ishte shpjegimi i të pandehurit se ndaj viktimës kishte qëlluar me një gjysmë tulle. Ndonëse i pandehuri nuk e çoi deri në fund këtë shpjegim, thënëni e dëshmitarit të lartpërmendur, konkluzioni i aktit të ekspertimit si dhe disa prova të tjera të grumbulluara të krijonin bindjen e plotë se autori i vrasjes së Josif Budos ishte i pandehuri Luan Allajbeu. Bindja për këtë veprim shoqërisht të rrezikshëm plotësohej akoma më tej, duke pasur parasysh se i pandehuri mbas ngjarjes kishte porositur disa policë që e kishin parë duke shtënë me pistoletë në vendin e ngjarjes, që gjatë pyetjeve në hetuesi të mos flisnin për këtë fakt. Këtë shpjegim që në fillim e dha vetë i pandehuri e konfirmuan më pas me shpjegimet e tyre dhe tre policë të qytetit të Kavajës.

Në përfundim të hetimit i pandehuri Luan Allajbeu u dërgua në gjyq për krimin e vrasjes, ndërsa dy sampistë u dërguan në gjyq gjendje të lirë për krimin e shpërdorimit të detyrës. Luan Allajbeu u dënua 20 vjet heqje lirie, ndërsa dy sampistët u dënuan me kohën e paraburgimit.

Hetuesia e rrethit të Durrësit po thellon hetimet për ngjarjet e grumbullimeve të paligjshme. Janë evidencuar pjesëmarrësit, janë marrë në përgjegjësi penale e arrestuar disa prej tyre dhe po vazhdon hetimi për të zbuluar e goditur gradualisht e në vazhdimësi organizatorët dhe pjesëmarrës të tjerë aktivë në grumbullimin e paligjshëm të datës 11.07.1990 në Kavajë.

Hetimi i kësaj çështjeje të rëndësishme penale, duke pasur parasysh vështirësitë dhe pengesat pa precedent që u krijuan, për një ekspertencë pozitive për organet e hetuesisë. Zbulimi dhe dënimi i autorit të vrasjes dhe i personit që shpërdori detyrën pati ndikim pozitiv në opinionin shoqëror në Kavajë. Hetimi objektiv rriti vlerësimin për punën e hetuesisë dhe besimin për çarjen deri në fund të hetimit të vrasjes dhe vënies para përgjegjësisë të fajtorëve. Kështu ndihmohet në forcimin e rendit juridik.

KRYETARI I HETUESISË SË PËRGJITHSHME  
QEMAL LAME  
(firma)

familjarët dhe masa e popullit në ligjë, nuk u lejuat të kryeshin veprimet. Pjesëtarët e grupit të hetuesve vajtën disa herë por u fyen, u kërcënuan rëndë dhe u kërkua të largohen nga vendi i ngjarjes dhe nga këqyrja e kufomës në shtëpinë e tij.

Grupi hetuesve u kthye katër herë pa bërë veprime për të mos e acaruar më tej gjendjen. Viktima u varros pa u kryer autopsia dhe ekspertimi mjekoligjor. Në këto situata, grupi i hetuesve organizoi hetimin mbi bazën e udhëzimeve të veçanta dhe planit të detajuar për kryerjen e veprimeve hetimore. Rëndësi iu kushtua kryerjes së atyre veprimeve që lidheshin me zbulimin e autorëve të vrasjes së Josif Budos.

Duke qenë se në shpjegimet e disa prej dëshmitarëve dille se gjatë veprimeve të sampistëve kishin qëlluar me armë dy sampistë, njëri nga Saranda dhe tjetri me bluzë me viza, u bë identifikimi i tyre. Rezultoi se ata ishin Bukurosh Koleci dhe Edmond Cullaj. Menjëherë u bë ndalimi i këtyre personave.

Ndërkohë që u bë ndalimi i dy policëve sampistë, vazhduan përpjekjet për këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe për të shtënë në dorë predhën e një plumbi që kishte mbetur në murin e jashtëm të një kinkalerie, para së cilës ndodhi vrasja e Josif Budos. Për shkak të vazhdimtë të pengesave në kryerjen e veprimeve hetimore, plumbi i mbetur në mur, u hoq që andej nga një person i paidentifikuar dhe me gjithë përpjekjet serioze, organet e hetuesisë nuk e shtinë në dorë atë deri në përfundim të hetimeve.

Moshtënia në dorë e kësaj prove të rëndësishme materiale, si dhe moskryerja e ekspertimit mjekoligjor të kufomës e vështirësuan seriozisht hetimin e plotë dhe të gjithanshëm të çështjes. Por e rëndësishme për t'u theksuar është se këto nuk u bënë shkaqe për humbjen e besimit për zbulimin e veprës penale dhe të autorit të saj.

Gjatë pyetjes të të pandehurve Edmond Cullhaj dhe Bukurosh Koleci u arrit që prej tyre të merreshin shpjegime të plota rreth ngjarjes së ndodhur. Të dy këta të pandehur shpjeguan se në vendin e ngjarjes, për shkak të rrethanave që ishin krijuar, kishin realizuar të shtëna me pistoletë me drejtim lart në ajër dhe jo duke ia drejtuar viktimës, ose ndonjë personi tjetër.

Për verifikimin e thënietve të këtyre të pandehurve u kryen disa veprime hetimore. Më i rëndësishmi prej të cilëve ishte paraqitja e tyre për njohje, dy personave, banorë të qytetit të Kavajës të cilët gjatë pyetjes si dëshmitarë, pretenduan se e njihnin sampistin që kishte shtënë me armë ndaj viktimës dhe e kishte vrrarë atë. Paraqitja për njohje u realizua në përputhje të plotë me kërkesat procedurale dhe ati taktikë të kryerjes së këtij veprimi hetimor. Asnjë nga dy dëshmitarët nuk ishte në gjendje të përcaktonte se cili ishte sampisti që kishte kryer vrasjen. Ky veprim hetimor veç kësaj, pati vlerë dhe për njohjen e shkallës së pasaktësisë në shpjegimet e këtyre dëshmitarëve, të cilët të sugjestionuar nuk ishin në gjendje të jepnin shpjegime të drejta për ngjarjen.

Nga banorë të qytetit të Kavajës u dorëzuan shtatë gëzhoja të gjetura rreth vendit të ngjarjes. Menjëherë u krye ekspertimi balistik për të gjetur armët me të cilat ishin realizuar qitjet. Për këtë qëllim u grumbulluan të gjitha pistoletat e të gjithë punonjësit të organeve të brendshme që kishin qenë në vendin e ngjarjes që u përkisnin 37 personave. E rëndësishme si konkluzion i aktit të ekspertimit balistik ishte se tre prej tyre u takonin qitjeve të realizuara nga një pistoletë, nga ajo e punëtorit të policisë së qytetit të Kavajës, Luan Allajbeu.

Mbas kalimit të disa ditëve nga ndodhja e ngjarjes, u krijuan kushtet për këqyrjen e vendit të ngjarjes. Ndonëse me mjaft vonesë, ky veprim hetimor jo vetëm që nuk u nënvlefësua, por u krye me kujdes të veçantë. Duke qenë se në derën e jashtëm të kinkalerisë u zbulua një vrimë, e cila kishte karakteristikat e vrimave që shkaktohen nga kalimi i predhës, brenda në dyqan u kërkua të gjendej predha. Mbas një kërkimi që zgjati për disa orë, u gjet predha që kishte depërtuar në dyqan duke kaluar nga vrima e derës,

## » EKSPOZITA


**E VEÇANTA** ishte edhe prezantimi i punimeve të ekspozitës nga Anila mbas propozimit të violinistit të njohur drejtues i grupit "Klandestin" Olen Çesari, i cili i kërkoi autoreve të shpjegonte magjinë e ngjyrave të ekspozitës që të ngjallin punimet në një mbrëmje pranverore pariziane

**FLORA NIKOLLA**  
TIRANE

Artistët e njohur Bujar Zajmi dhe Anila Zajmi Katanolli, atë e bijë, po prezantohen së bashku në një ekspozitë në Espace, place 26 Denfert Rochereau, Paris 14, ekspozitë e cila duket se ka ngjallur interes në dashamirës të artit dhe miq të qëndres Albinfo, e cila prej kohësh prezanton artin shqiptar në shumë diapazone.

Në një korespondencë për ATSH-në, Zamir Mati, Piktori i Merituar, me banim në Paris shkruan se, "Bujar Zajmi piktor grafist i shquar i artit shqiptar prezanton në këtë ekspozitë një seri kolazhesh dhe ndërthurje me ngjyra akuarele, guashe dhe pastele".

Ai zgjodhi të prezantojë kërkimet e tij në tematikën e preferuar të përshtypjeve të hershme të figurave dhe njollave piktorike të cilat duke u rikujtuar dhe sjellë në kuadrat e kompozimeve dhe ndërthurjet e vizatimit e ngjyrave të cilat krijojnë një atmosferë të freskët të temave dhe momenteve të preferuara të këndvështrimit të tij, fshatarët malësorë dhe të Shqipërisë së mesme. "Bujar Zajmi luan me vizatimin dhe me shkathësi vendos ngjyrat pa një obligim të respektimit të asaj që në jemi mësuar të shohim shpesh herë në imitimin e realez. Ai kështruhet abstragon me vizatimin dhe ngjyrën duke na dhënë me forcën e një këndvështrim original përshtypjen e një gjënde të re, të freskët, me ngjyra të gjalla që ndihmohen nga kontrastet grafike. Këto qëndrime të një kërkimi krijues artistik nuk janë të reja në krijimtarinë e tij të gjatë në kohë ku ai ka formuar personalitetin e Tij", cilëson Zamir Mati. Në fakt, Bujar Zajmi qysh herët është dalluar në grafikën shqiptare e sidomos në ilustrimet e librave dhe revistave të fëmijëve për linjën e shkathët që shoqërohej nga ngjyrat e forta pothuaj të vendosur në mënyrë abstrakte në vazhdimësinë e tyre. Herë herë zgjidhja me humor e vizatimit të personazheve të tregimeve apo të poemave e vjershave të ilustruara prej tij të çudisnin për guximin e realizimit të tyre. Të njëjtën karakteristikë ruan Bujar Zajmi edhe tani në punimet e viteve të fundit. Veprat e tij tregojnë një zotërim të mjeshtërisë artistike të cilat kështu formojnë figurën dhe origjinalitetin e një piktori të veçantë të artit pamor shqiptar. Ndërsa Anila Zajmi Katanolli prezanton në këtë ekspozitë një seri punimesh të cilat janë kërkime dhe studime të vazhdueshme të artistes. Asaj i intereson figura e njeriut dhe kjo në ato pozicione e poza të cilat nxjerrin në pah veshjet dhe dekorin e tyre. Ajo frymëzohet dhe pasuron figurat e saj me qëllimin kryesor të pasurimit të koleksionit të saj nga i cili nxjerr me një eksperiençë mjeshtërore e ndërton modele të reja për figurat e saj kostumografike që prej vitesh shoqërojnë shfaqet e operas, teatrit apo sfilatave prezantuese të krijuara prej saj. Duket që punimet e Anilës janë më të plota e të ndryshme e me një origjinalitet por në të ndjehen dhe kupton se ajo ka ditur të marrë nga krijimtaria e të atit atë veçanti të cilën ajo e çon më tej, e pikërisht



# Bujar dhe Anila Zajmi së bashku në Paris

Atë e bijë, po prezantohen së bashku në një ekspozitë në Espace, place 26 Denfert Rochereau, Paris 14

është guximi krijues, ndalja tek motivet dekorative kombëtare dhe vendosja e tyre në një kontekst dhe formë moderne. Punimet e Anilës janë një seri e zgjedhur nga një mori e tërë punimesh të realizuara prej ateliesë së saj "objekt d'art", shkruan Mati. E veçanta e këtij aktiviteti ishte edhe prezantimi i punimeve të ekspozitës nga Anila mbas propozimit të violinistit të njohur drejtues i grupit "Klandestin" Olen Çesari, i cili i kërkoi autoreve të shpjegonte magjinë e ngjyrave të ekspozitës që të ngjallin punimet në një mbrëmje pranverore pariziane. Violinisti i shquar Olen Çesari

e ftoi muzikanten Linda Rukaj e cila studion në Qendrën Ndërkombëtare Amerikane të Edukimit Muzikor në Paris, të luante me kitaren e saj. Ai ftoi gjithashtu të pranishmit në koncertin e tij i cili do të zhvillohet në Qendrën Kulturor të Republikës Italiane në Paris në kujdesin e ambasadorëve të Italisë dhe Shqipërisë në Francë. Në këtë mbrëmje mori pjesë edhe ambasadori i Shqipërisë në Francë Dritan Tola i cili duke falënderuar autorët e ekspozitës dhe artistët pjesëmarrës u shpreh, "se ju jeni ambasadorët e vërtetë të Shqipërisë që përhapni me punën e veprat tuaja

kulturën dhe artin shqiptar në botë e këtu në Europë". Qendra ALBINFO, nga një aktivitet në tjetrin, po merr tËparet e Shtëpisë së Shqipërisë. ALBINFO e drejtuar nga zoti Gjergj Themeli me këshillin artistik të përbërë nga Agron Hasku, profesor universitar i gjuhës frënge, Luan Rama shkrimtar dhe publicist, Georges Leka studjues në fushën e gjuhëve të vjetra të lidhura me civilizimin e hershëm europian, Zamir Mati, Piktori i Merituar, me programin e zgjedhur vjetor prezantojnë kulturën shqiptare nëpërmjet aktiviteteve të larmishme.

### BIENALE E ARTIT

## Venecia 2015, pavioni shqiptar mbledh vizitorë të shumtë

Në Bienalen artit "Venecia 2015" u çel gjatë ditës së djeshme (6 maj 2015) pavioni shqiptar u përfaqësua nga artisti Armando Lulaj dhe kuratori Marco Scotini me "Albanian Trilogy: A Series of Devious Stratagems". Pavijoni u hap nga Ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro. Ministria në fjalën e saj theksoi se "Bienalja ndërkombëtare e Venecias është rasti më i mirë për t'u njohur, falë urave të Artit, Kulturës dhe komunikimit bashkëkohor. Sot Shqipëria flet me punën e kuratorit të njohur Marco Scotini dhe artistit shqiptar Armando Lulaj, me "Trilogjinë shqiptare" që vjen me mesazhe politike dhe estetike, me metafora të fuqishme dhe imazhe të mirëfillta të një vendi

me potenciale të mëdha". Ndërkohë kuratori Marco Scotini u shpreh se është i rëndësishëm fakti që për të parën herë Shqipëria prezantohet me një Pavijon qendror në Bienalen e Artit të Venecias. Ndërsa Presidenti Paolo Baratti theksoi rreth eventit se është një "Ekspozitë e Artit" ku kthehet vëmendja mes Artit dhe Zhvillimit social e politik botëror, duke parë sesi tensionet e kohës që jetojmë përkthehen në sensibilitetin, energjinë krijuese, ekspresivitetin dhe shpirtin e Artistëve. Pavijoni shqiptar tërhoqi vizitorë të shumtë mes të cilëve koleksionist shumë të njohur, kritikë arti, drejtues muzeesh dhe galerish të rëndësishme, gazetarë e artistë, shqiptarë dhe të huaj.



### Teatri i Operës

Koreografi i njohur portugez Daniel Cardoso ngjiti premierën "4 pieces"



Këtë të shtunë në datën 09 maj 2015. Ora 20.00 do të kemi një tjetër premierë baleti në TKOB. Rikthehet koreografi i njohur portugez, Daniel Cardoso, me 4 pjesë të reja koreografike moderne e titulluar "4 pieces". Getting Up - pjesa e parë sjell njeriun e vërtetë, të zhveshur nga rrobat e përditshme duke treguar në këtë mënyrë thelbin e tij. Encounters - është një duet ku dy njerëz takohen, tërhiqen, keqkuptohen dhe ndahen. No commo... do të thotë "në fillim" dhe tregon marrëdhënien në komunitet, dhe nevojën për t'u kthyer pas për të gjetur përgjigje. Fado - kjo pjesë që është edhe më gjata (40 min) e ka marrë emrin prej kësaj pjesëze të kultures portugeze, ku fado është muzika që zhvillohet në rrugat e qytetit, e pashkruar dhe e trashëguar brez pas brezi. Nën tingujt e kësaj muzike të bukur me një skenografi të veçantë dhe "të ujshme" balerinet do të përcojnë tek publiku artin e tyre, bukurinë dhe lirshmerinë e ndjesive në mënyrë të shkujdesur, atë që shqisat perceptojnë dhe zemrat ndjejnë...



# Big brother

## Flirt mes Milenës dhe Fisnikut, Tea në dilemë?



Milena dhe Fisniku janë në oborr duke pirë cigare. Ata flasin për lojën dhe misionin që duhet të kryejnë. Milena i thotë Fisnikut se nuk ka gjumë dhe i kërkon që ai të shkojë për të fjetur. Fisniku nuk pranon duke i thënë se në këtë lojë nuk ka besim tek asnjëri. Milena i ka premtuar Albës se do mbështesë bekimin e dashurisë së saj si Zhuljeta dhe po mundohet të bëjë më të mirën. Ajo nuk e di që veshja e Romeo-s është fshehur dhe misioni i tyre nuk mund të kryhet. Ditë shkuar ajo ka shprehur interes për Fisnikun. Ata pasi pinë cigaren zhvendosen në dhomën e ndenjës. Fisniku shtrihet dhe Milena i bashkohet. Ajo i qëndron shumë pranë dhe fillon që ta provokojë jo vetëm me fjalë por dhe geste. Fisniku i thotë se ajo nuk ka limite. Ajo pranon duke thënë se nuk ka pse të ketë. Si për ta kujtuar që në lojë është dhe Fabiani, ai e pyet se ç'po ndodh me ta dhe se si po shkon basti. Milena flet me mos përfillje dhe fillon ta kafshojnë në trup. Fisniku mundohet që ta largojë, por ajo nuk ndalet me aq. "Ti vdes për... unë të shohë dhe ndjej si je... i ke sytë flakë" i thotë Milena duke e provokuar nëse i ka nga gjumi apo jo. Fisniku qesh dhe i thotë: "jo nuk e kam nga gjumi por nga diçka tjetër". Ata shihen për pak çaste në sy dhe buzëqeshin. Milena e pyet nëse është lyer me parfum. Fisniku përgjigjet: "jo nuk jam lyer... është parfumi i Teas". Fisniku i kërkon që ajo të shkojë për të fjetur por më kot. Ajo është e vendosur të qëndrojë me të por tashmë jo për misionin. Ai e merr në krah dhe e çon në shtratin e saj. Pas kësaj ai shtrihet afër Teas. Milena ngihet nga shtrati i saj dhe e fton Fisnikun të dalin jashtë. Ai nuk ngrihet dhe Milena dorëzohet. Tashmë të gjithë banorët janë në gjumë.

### Grupi

## Ribashkohet 'Asgje sikur dielli', gati albumin

— Grupi i mirënjohur kosovar ribashkohet me vokalin Alban Nimani dhe rikthehen në skenë me albumin e ri. Pas një ndërprerje prej 4 vitesh, kur Alban Nimani provoi karrierën si solist, grupi 'Asgje sikur dielli' vendosi të ribashkohet për të publikuar albumin e ri, të tretin me rradhë. Grupi rikthehet në përbërjen: Bujar Hudozi në kitarë, Alban Nimani në vokal, Fatos Berisha në timpane, Labint Krasniqi në bas dhe Faton Dolaku në tastiere. Albumi i ri që pritet të publikohet së shpejti do të ketë 8 këngë. Alban Nimani pas publikimit të lajmit për ribashkim deklaroi: "Jam i gëzuar që rikthehem në grupin ku kam filluar karrierën. Jam kthyer në shtëpi, dhe adhuruesve tanë do t'u sjellim këngë që i kanë pritur gjatë". 'Asgje sikur dielli' është formuar në vitin 1996, dhe deri tani ka publikuar dy albume, me titull '1' në vitin 1999 dhe 'Ndodhemi' me 2004.



### Kalendari Kulturor

#### AKADEMIA E FILMIT "MARUBI"

- Nga data 7 - 10 maj në Akademinë e Filmit dhe Multimedias "Marubi" do të mbahet edicioni i parë i Festivalit të Filmit Izraelit. Ky festival organizohet nga Ambasada e Izraelit në bashkëpunim me Akademinë e Filmit & Multimedias "Marubi". Gjatë katër ditëve të IFFA, janë përzgjedhur të shfaqen katër prej filmave më të suksesshëm e më të vlerësuar në festivale ndërkombëtare, të kinematografisë bashkëkohore izraelite. 1- Të enjten, më 7 maj, ora 19:00 do shfaqet "Footnote" (2011) nga Joseph Cedar, nominuar për Oscar Academy Awards 2012, SHBA në kategorinë e filmit më të mirë në gjuhë të huaj. 2- Të premten, më 8 maj, ora 19:00 do shfaqet "Aviva, My Love" (2006) nga Shemi Zarhin, Çmimi i Akademisë Izraelite të Filmit 2006, 10 çmime dhe 8 nominime, etj. 3- Të shtunën, më 9 maj, ora 19:00 jepet filmi "The Flood (Mabul)" (2010) nga Guy Nattiv me 4 çmime & 6 nominime. 4- Të dielën, më 10 maj, ora 19:00 do shfaqet filmi "The Band's Visit" (2007) nga Eran Kolirin, me 46 çmime & 15 nominime. Të gjithë filmat do të jenë me titrat në shqip. Hyrja si gjithmonë është e lirë/falës.



#### PROGRAMI I FILMAVE NE RRJETIN IMPERIAL PER DT 07.05.2015 - 13.05.2015

##### SALLA 1

- "Hot Pursuit" 2D / 15:30 / 20:30 / 22:15 / Çmimi 500 Leke
- "Child 44" 2D / 18:00 / Çmimi 500 Leke
- "Avengers Age of Ultron" 3D / 13:00 / Çmimi 500 Leke
- "Home" 3D / 10:30 / Çmimi 400 Leke

##### SALLA 2

- "Child 44" 2D / 16:00 / 21:00 / Çmimi 500 Leke
- "Hot Pursuit" 2D / 18:30 / Çmimi 500 Leke
- "The Age Of Adaline" 2D / 13:30 / Çmimi 500 Leke
- "Avengers Age of Ultron" 3D / 11:00 / Çmimi 500 Leke

#### KINEMA AGIMI

- "Avengers Age of Ultron" 3D / 10:00 / 15:00 / 17:30 / Çmimi 500 Leke
- "Hot Pursuit" 2D / 12:30 / 20:00 / Çmimi 500 Leke
- "Child 44" 2D / 21:45 / Çmimi 500 Leke

##### Premiere Dt 14.05.2015

- 1-Mad Max:Fury Road 3D

DYLBER BALLA  
TIRANE

Përfundon me humbje miqësorja e luksit të Shqipërisë përballë Gjermanisë 3-4. Sfida e zhvilluar në stadiumin "Elbasan Arena" u prit me mjaft interes nga shumë adhurues të futbollit gjerman, por edhe idhujve kuqezinj. Edhe pse ishte një ndeshje miqësore e brezave, Shqipëria përsëri nuk arriti që të merrte një fitore përballë gjermanëve duke pësuar një tjetër humbje. Humbja 3-4 risjell në memorien e shumë shqiptarëve atë të 1997 ku kuqezinjtë ishin fare pranë një rezultati historik, por u mundën me të njëjtin rezultat. Golat për kuqezinjtë u realizuan nga Alban Bushi 34' e 43' dhe Kola 40+1'. Për gjermanët shënuan Bobic 16', Reich 19', Albertz 48', 54'. Nga tre golat e Shqipërisë vien të theksohet ai i realizuar nga Agustin Kola me penallti me parabolë, që ngriti në peshë stadiumin duke marrë duartrokitjet e spektatorëve. Trajneri i ekipit Kombëtar ishte Astrit Hafizi, ndërsa tekniku gjerman ishte Eckerhad Kratzun. Të ardhurat e miqësore do të shkojnë për ndërtimin e një fushe futbollit për personat me aftësi të kufizuara.

## HISTORIA E CANËS

Kapiteni i ekipit kombëtar të futbollit Lorik Cana gjithmonë arrin që të tërheqë vëmendjen e mediave dhe opionit sportiv me historinë e jetës së tij në fushë dhe jashtë saj. Lorik Cana bashkë me Etrit Berishën dhe disa lojtarë të Lazios vizituan shkollën multietnike 'Salvini' që ndodhet në Via Caposile të Romës. Ata ishin e debatit "Nga shkolla në stadium". Gjatë fjalës së tij, Cana i është përgjigjur interesimit për karrierën e tij mbi vështirësitë, sukseset dhe dështimet që ka arritur deri tani. Pyetjes së cila ka qenë ndeshja dhe kundërshtari më i vështirë në karrierën e tij, kapiteni kuqezinj ka deklaruar se "Ndeshja më e vështirë në të cilën kam luajtur ka qenë kundër Holandës së Van Persiet. Momenti më i mirë ishte kur fituam Kupën e Italisë me Lazion. Debutimi me PSG, dhe kur vesha fanellën e Kombëtares



# Gjermania fiton në miqësoren e veteranëve 3-4 ndaj Shqipërisë

Golat për kuqezinjtë u realizuan nga Alban Bushi 34' e 43' dhe Kola 40+1' me penallti një eurogol

Shqipëria mbetet në vendnumëro në renditjen e publikuar nga FIFA për muajin Maj, në pozicionin e 57 me 575 pikë

shqiptare. Ishte një emocion unik, sepse në atë moment je i vetëdijshëm se po përfaqëson një popull të tërë" deklaroi ai.

## RENDITJA E FIFA-S

Shqipëria mbetet në vendnumëro në renditjen e publikuar nga FIFA për muajin Maj, në pozicionin e 57 me 575 pikë. Shkak i mosndryshimit të vendit

për këtë muaj ka qenë fakti që ekipet kombëtare nuk kanë pasur aktivitet. Edhe kundërshtarët e Shqipërisë

në grup përveç Danimkës nuk kanë pasur ndryshime pozicioni. Gjermania vazhdon të kryesojë.



Shifrat

4

## Gola

Pësoi Shqipëria në ndeshjen ndaj Gjermanisë, të cilët u shënuan nga Bobic 16', Reich 19', Albertz 48', 54'.

575

## Pikë

Ka grumbulluar Shqipëria për muajin Maj në renditjen e FIFA duke mbetur në vendin e 57, kombëtares s'kanë pasur aktivite.

29

## Maj

FSHF ka njoftuar se do të jepet vendimi i CAS-it për dhunën që ndodhi në Beograd në ndeshjen Serbi-Shqipëri më 14 Tetor 2014.

7

## Pikë

Ka Shqipëria në grupin '1' dhe në rast se do të marrë tre pikët merr kryesimin e grupit, në Qershor ndeshje miqësore me Francën.

## Shkurt

## VENDIMI


### Kombëtarja, De Biasi presion CAS-it për 3 pikët

— Në prag të vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv, De Biasi vazhdon që të bëjë presion për tre pikët. Këtë herë përmes mediave italiane ai deklaroi se "Ajo ndeshje duhet të ndërpritej përpara se të futej droni. Nuk mund të luhej kurrsesi në ato kushte. Lojtarët e Serbisë u treguan shumë korrektë ndaj nesh, madje Kolarov më shoqëroi deri në tunel. Sikur te merrnim 3 pikët, do të ishte ndryshe".

## SUPERIORE

### Tirana, Curri humbet ndeshjen me Skënderbeun

— Debatik Curri nuk do të jetë i gatshëm për ndeshjen e të shtunës që Tirana do të luaj me Skënderbeun në "Qemal Stafa". Mbrojtësi nuk ka pasur përmirësim në gjurin e fryrë pas ndeshjes me Partizanin. Curri do të pushoj këtë fundjavë për t'u rikthyer në ndeshjen e radhës më pas me Kukësin. Përvë Currit me Skënderbeun do të mungojnë edhe Muzaka me Bulkun.



## EUROPA LEAGUE

### Sevilja prek finalen Napoli ndalet në barazim

— Futboli spanjoll vazhdon dominimin në Europë. Pas Champions League ka qenë radha e Europa League për luajtur gjysmëfinale. Kampionia në fuqi, Sevilja thuhet ka siguruar finalen, pasi ka mundur Fiorentinën 3-0 me golat e Vidal y herë, dhe Gameiro. Në ndeshjen tjetër Napoli cilësohet favorit përballë Dnipro, por nuk arriti të marr më shumë se një barazim 1-1, golat u shënuan nga Lopez dhe Seleznyov duke lënë të hapur kualifikimin në ndeshjen e dytë.

## CHAMPIONS/ GJYSËMFINALET

## Planeti elozhe Mesit 'kryqëzohet' Bayern


— Lionel Messi ka folur pas ndeshjes me ekipin e Bayernit të Mynihut duke deklaruar se "Ne ishim me fat që shënuam golin e parë. Pastaj erdhën të tjetër në një periudhë të shkurtër. Rezultati është shumë i mirë, por akoma nuk ka përfunduar asgjë, pasi duhet të jemi të kujdesshëm në ndeshjen e kthimit. Gjermania do të

jetë e vështirë. Ne kemi një rezultat të mirë, por duhet të shkojmë atje dhe të mos e ulim ritmin" thaj ai. Karl-Heinz Rummenigge beson se Bayerni në ndeshjen e kthimit do të bëjë mrekullinë, ashtu sikur ndodhi me Porton. "Rezultati 3-0 në Barcelona na la një shije të hidhur, por unë kam besim se ekipi mund të përbysë rezultatin

## Rregulli

Në finalen e Berlinit do të mungojnë vetëm lojtarët që dalin me të kuqe në gjysmëfinale sipas rregullit të ri. UEFA ka vendosur të gjithë kartonët e verdhë do të vlejnjë nga faza e grupeve deri në çerekfinale.

në ndeshjen e kthimit"deklaroi ai. Mediat spanjolle kanë zbardhur edhe një debat të Guardiols me Mulerin pas zëvendësimit duke treguar se atmosfera në kampin gjerman nuk është aspak pozitive. Guardiols i



duhet shumë punë për të bashkuar grupin dhe për ta bindur psikologjikisht që mund të bëjë mrekullinë në ndeshjen e kthimit. UEFA ka zgjedhur formacionin e javës ku gjithçka nis me Neuer në portë, pavarësisht pësimit të 3 golave, ndërsa në mbrojtje janë vendosur Dani Alves, Javier Mascherano, Leonardo Bonucci dhe Giorgio Chiellini. Raktic, Vidal dhe Markizio janë vendosur në mes-fushë, ndërsa në sulm Messi, Neymar dhe Tevez.



LAJME

**nga bota**

**Kosovë, 32 akuza për terrorizëm**


— Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti dje aktakuzë pranë Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Prishtinë kundër 32 të pandehurve për veprat penale: "Rekrutimi për terrorizëm", "Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste" dhe "Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve". Për disa nga të akuzuarit ekziston dyshimi i bazuar se janë bashkëngjitur për të luftuar grupit ISIS në Siri, të tjerë kanë bërë ftesë për t'u bashkuar ISIS-it, ndërsa disa të tjerë kanë rekrutuar njerëz për të dërguar në luftën e Sirisë dhe kanë mbledhur fonde për organizatat e sipërpërmendura, të shpallura si terroriste nga OKB-ja.

**Vijon protesta në Maqedoni**

— Edhe ditën e djeshme kanë vijuar protestat kundër qeverisë Gruevski pas publikimit të përgjimeve, ku diskutohet mbulimi i një vrasjeje të kryer nga një efektivi policie. 10 mijë protestues marshuan drejt Parlamentit, duke thirrur "Vrasës", "Gruevski ik", "Nuk ka drejtësi, nuk ka paqe", etj. Ndër protestuesit, ishin gati të gjithë përfaqësuesit e opozitës maqedonase. Pakënaqësitë janë shtuar pas zbardhjes së bisedave të përgjuara nga ana e opozitës maqedonase, ku dalin detaje lidhur me vdekjen e gazetarit dhe botuesit të revistës "Fokus" Mladenov më 2013.

**Zgjedhje parlamentare në Britani**

— Miliona njerëz votuan dje në zgjedhjet e përgjithshme të Mbretërisë së Bashkuar. Kutitë e votimit në rreth 50.000 qendra u hapën në orën 7:00, sipas orës lokale dhe u mbyllën në orën 22:00. Janë rreth 50 milionë qytetarë në të gjithë Britaninë të cilët mund të votojnë. Kryeministri David Cameron, i cili ka udhëhequr koalicionin me Liberal-Demokratët që prej vitit 2010, ka thënë se vendi është më i fuqishëm se pesë vjet më parë dhe ka shprehur bindjen se Konservatorët do t'i fitojnë zgjedhjet. Partia Laburiste është rivalia kryesore e Konservatorëve të Cameron. Udhëheqësi i saj, Ed Miliband, ka thënë se është optimist për rezultatet e Laburistëve.



**NGA E HËNA NË TË PREMTE 20:15**

**PERSONAZHET E "FRIENDS" QË KANË PUSHTUAR ZEMRAT E MILIONA NJERËZVE, VIJNË EKSKLUZIVISHT NË A1REPORT DHE PËR HERË TË PARË NË CILESINË MAKSIMALE HD**



**TELEVIZIONI I LAJMEVE NDRYSHE NGA TË TJERËT!**



Alba Malltezi - Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group ; Aurel Pepa - Zv/kryeredaktor  
Genc Kondi - Administrator i Përgjithshëm; Admirina Peçi - Kryeredaktore e "Rilindasi" ; Politika: Juxhin Mustafaraj ; Ekonomi: Lorenc Rabeta; Aktualitet: Elton Qyno ;  
Sociale: Sonila Isaku; Kulturë: Dhurata Hamza; Sporti: Dylber Balla; Design: Altin Aliaj, Erjon Ymeri; Website: Greta Malaj; Shpërndarja: Spiro Meshini cel: +3556960088847

Departamenti i Marketingut:  
Patricia Costantinescu  
Cel: +355696060419  
marketing@shqiptarja.com

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421- Shtypur në shtypshkronjën: KLAS5 shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë